



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 115

Tiranë – E enjte, 23 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 56/2016 datë 2.6.2016	Për disa ndryshime në ligjin nr. 33/2014, “Për miratimin e huamarrjes prej 295 420 000 SDR-sh, që Fondi Monetar Ndërkombëtar i akordon Shqipërisë për programin 36-mujor të ndihmës (EFF)”..... 8191
Ligj nr. 57/2016 datë 2.6.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 8191
Ligj nr. 58/2016 datë 2.6.2016	Për ratifikimin e dokumentit të ndryshimit të marrëveshjes së huas, të ratifikuar me ligjin nr. 89/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”..... 8204
Ligj nr. 59/2016 datë 2.6.2016	Për ratifikimin e vendimit të Komisionit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore nr. 3/2015, për ndryshimin e vendimit të Komisionit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore 3/2013, në lidhje me aneksin 4, të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA 2006), protokollit për përkufizimin e konceptit të “Produkteve të origjinës” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, të referuara në nenin 14, paragrafët 1 e 3..... 8210
Ligj nr. 60/2016 datë 2.6.2016	Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve..... 8218
Ligj nr. 61/2016 datë 2.6.2016	Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë..... 8225
Ligj nr. 62/2016 datë 2.6.2016	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar..... 8226

Ligj nr. 63/2016 datë 2.6.2016	Për një ndryshim në ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.....	8227
Ligj nr. 64/2016 datë 2.6.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si Agjencia e Zbatimit të Projektit, dhe KfW Frankfurt am main për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri–Kosovë (Tiranë–Prishtinë)”, nëpërmjet një huaje prej 42 000 000 eurosh.....	8227
Dekret i Presidentit nr. 9645, datë 14.6.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8229
	Ndreqje gabimi në nenin nr. 63 të ligjit nr. 136/2015, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 220/2015.....	8229



LIGJ
Nr. 56/2016

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 33/2014, “PËR MIRATIMIN E HUAMARRJES PREJ 295 420 000 SDR-SH, QË FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR I AKORDON SHQIPËRISË PËR PROGRAMIN 36-MUJOR TË NDIHMËS (EFF)”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 156, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në aneksin nr.1, bashkëlidhur ligjit nr. 33/2014, “Për miratimin e huamarrjes prej 295 420 000 SDR-sh, që Fondi Monetar Ndërkombëtar i akordon Shqipërisë për programin 36-mujor të ndihmës (EFF)”, paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

“Komisioni i angazhimit aplikohet në çdo fillim periudhe 12-mujore, nga data e aprovimit të huas në bordin e FMN-së, mbi shumatat që parashikohet të tërhiqen gjatë kësaj periudhe. Norma e këtij komisioni është 15 bp (0,15%) për shumata të angazhuara deri në vlerën 115% të kuotave të anëtarësisë së Shqipërisë në FMN (që janë 139,3 milionë SDR), 30 bp (0,3%) për shumata të angazhuara në vlerat 115% - 575% të kuotave, ndërsa për shumata të angazhuara që e kalojnë këtë vlerë, norma e komisionit rritet në 60 bp (0,6%).”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.6.2016

Shpallur me dekretin nr. 9636, datë 14.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

ANEKSI 1

Në aneksin 1 të ligjit nr. 33/2014, “Për miratimin e huamarrjes prej 295,420,000 SDR, që fondi Monetar Ndërkombëtar i akordon Shqipërisë për programin 36-mujor të ndihmës (EFF)” në paragrafin e katërt të tij mbi “komisionin e angazhimit”, propozohet të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Komisioni i Angazhimit aplikohet në çdo fillim periudhe 12-mujore, nga data e aprovimit të huasë në Bordin e FMN-së, mbi shumatat që parashikohet të tërhiqen gjatë kësaj periudhe. Norma e këtij komisioni është 15 bp (0.15%) për shumata të angazhuara që deri në 115% të kuotave të anëtarësisë së Shqipërisë në FMN (që janë 139.3 milionë SDR), 30 bp (0.3%) për shumata të angazhuara në vlerën 115%-575% të kuotave, ndërsa për shumata të angazhuara që e kalojnë këtë vlerë norma e komisionit rritet në 60 bp (0.6%).

Paragrafët e tjerë të aneksit 1 nuk ndryshojnë.

LIGJ
Nr. 57/2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9936, DATË 26.6.2008, “PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 157 dhe 159, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. “Njësi të qeverisjes së përgjithshme” janë tërësia e njësisive të qeverisjes qendrore, vetë-qeverisjes vendore dhe të fondeve speciale.”

2. Pika 34 ndryshohet si më poshtë:



“34. “Menaxhimi financiar dhe kontrolli” është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike.”.

3. Pika 35 ndryshohet si më poshtë:

“35. “Kontroll i brendshëm financiar publik” është tërësia e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ushtrohet nga njësitë publike, për të garantuar se menaxhimi financiar dhe kontrolli i njërive të sektorit publik është në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi. Kontrolli i brendshëm financiar publik përfshin të gjitha veprimtaritë, me qëllim kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve të njërive publike. Ai, gjithashtu, përfshin harmonizimin qendror dhe koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të auditimit të brendshëm.”.

4. Pas pikës 44 shtohen pikat 45, 46, 47, 48 e 49 me këtë përmbajtje:

“45. “Sistemi informatik financiar i Qeverisë (SIFQ)” është sistemi financiar, nëpërmjet të cilit Qeveria e Republikës së Shqipërisë kryen të gjitha proceset e ekzekutimit dhe raportimit financiar të Buxhetit të Shtetit.

46. “Ligjet tatimore”, në kuptim të këtij ligji, janë ligjet që përcaktojnë nivelin e taksave apo tatimeve të veçanta në fushat specifike të tatimeve e taksave, kombëtare e vendore, administrimin e detyrimeve tatimore, si dhe organizimin dhe funksionimin e administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë.

47. “Garancia shtetërore e huas” është marrëveshja e lidhur me shkrim, e cila përmban rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti është përgjegjës për detyrimet financiare të një huamarrësi, kur ai nuk arrin t'i paguajë ato në kohën dhe masën e duhur.

48. “Veprimtari pothuajse fiskale” janë veprimtari që kryhen nga institucione shtetërore jobuxhetore, të cilat kanë kosto direkte ose indirekte në buxhetin e shtetit.

49. “Projekt investimi” është një seri puni-mesh, aktiviteteve apo shërbimesh, që synojnë të përmbushin një objektivi të pandashëm të një natyre specifike ekonomike apo teknike, me qëllim qartësisht të identifikuar.”.

Neni 2

Në nenin 4, paragrafi i parë, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) barazia gjinore, e cila i referohet situatës ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësi dhe akses të barabartë në të drejta dhe përfitime të së njëjtës natyrë.”.

Neni 3

Pas nenit 4 shtohen nenet 4/1, 4/2, 4/3 dhe 4/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Parimet dhe rregullat fiskale

Buxheti programohet dhe zbatohet duke mbajtur parasysh këto parime:

1. Qëndrueshmërinë e borxhit publik, që konsiston:

a) në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto;

b) përjashtim nga rregulli i shkronjës “a” mund të bëhet vetëm në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në nenin 4/4 të këtij ligji;

c) vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (*World Economic Outlook*), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqëruar të ligjit vjetor të buxhetit;

ç) në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0,7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit;



d) në çdo ligj vjetor fillestar të buxhetit, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, kur rritja reale e Produktit të Brendshëm Bruto, e parashikuar në raportin respektiv “Perspektiva ekonomike botërore”, të FMN-së, është, të paktën 5 për qind, atëherë deficitin i përgjithshëm nuk mund të jetë më i lartë se 2 për qind e Produktit të Brendshëm Bruto, përveç rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të nenit 4/4, të këtij ligji;

dh) në fazat monitoruese të buxheteve faktike, nëse për shkak të rishikimeve të mundshme të PBB-së nominale ose për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit, që përdoren për vlerësimin e stokut faktik të borxhit publik, rezulton se raporti i borxhit publik ndaj PBB-së nuk është më i ulët, kundrejt nivelit të vitit pararendës, atëherë, si rregull, këto devijime duhet të kompensohen në planifikimet e viteve buxhetore pasuese.

2. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

3. Ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal. Ligjet tatimore konsultohen paraprakisht me përfaqësuesit e biznesit dhe grupe të tjera interesi, në strukturat e ngritura për këtë qëllim.

4. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Neni 4/2

Minimizimi i riskut për veprime ekstrabuxhetore

Stoku total i garancive shtetërore, të lëshuara nga qeverisja e përgjithshme, përfshihet në masën 100 për qind të tij si pjesë përbërëse e stokut total të borxhit publik faktik të çdo viti buxhetor.

Çdo hua e huaj, që merret gjatë një viti buxhetor nga çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme, duhet të përfshihet në pasqyrën fiskale të konsoliduar të buxhetit vjetor të qeverisjes së përgjithshme, si pjesë e financimit të deficitit buxhetor.

Njësitë jo të qeverisjes së përgjithshme, përfituese të fondeve buxhetore dhe/ose garancive shtetërore, u nënshtrohen të njëjtave rregulla dhe procedura për shqyrtimin dhe miratimin e investimeve publike, të zbatueshme nga njësitë e qeverisjes qendrore. Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme, dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Ministria e Financave vlerëson dhe miraton, paraprakisht, të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve, individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Kuvendi, në ligjin vjetor të buxhetit, miraton tavanin e vlerës totale të kontratave në përqindje të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishitazi gjatë vitit buxhetor korrent.

Neni 4/3

Kontrolli i ekzekutimit të buxhetit në vitet elektorale

Në vitet buxhetore, gjatë të cilave mbahen zgjedhjet e përgjithshme, ekzekutimi i deficitit buxhetor të qeverisjes së përgjithshme, përveç rasteve të jashtëzakonshme, të parashikuara në nenin 4/4, të këtij ligji, bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij neni si më poshtë:

a) ekzekutimi i deficitit deri në fund të tremujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 30 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;

b) ekzekutimi i deficitit deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 55 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;



c) ekzekutimi i deficitit deri në fund të nëntëmujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 80 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor.

Neni 4/4

Rastet e rrethanave të jashtëzakonshme

Rrethana të jashtëzakonshme, për efekt të këtij ligji, cilësohen rastet kur:

a) ndodhin katastrofa ose fatkeqësi natyrore, aksidente teknologjike apo situata të tjera, të paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të Qeverisë, të cilat rrezikojnë jetën dhe shëndetin e shtetasve shqiptarë;

b) rrezikohet qëndrueshmëria e sistemit financiar dhe gjykohet e domosdoshme ndërhyrja nga Buxheti i Shtetit;

c) shpallet gjendja e luftës;

ç) rritja reale e Produktit të Brendshëm Bruto, e parashikuar në raportin respektiv “Perspektiva ekonomike botërore”, të FMN-së, është 1 për qind ose më e ulët se 1 për qind dhe kur, në të njëjtën kohë, raporti i borxhit publik është dhe qëndron poshtë nivelit prej 60 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto.”.

Neni 4

Në nenin 5, paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

“Fondi i kontingjencës krijohet për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit.”.

Neni 5

Në nenin 6, paragrafi i pestë hiqet dhe paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

“Fondi i kontingjencës mund të krijohet për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave.”.

Neni 6

Në nenin 8, paragrafi i fundit shfuqizohet.

Neni 7

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Deficiti dhe suficiti buxhetor

Deficiti buxhetor, në një vit buxhetor, është diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, kur shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat.

Suficiti buxhetor, në një vit buxhetor, është diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, kur të ardhurat janë më të mëdha se shpenzimet.

Ligji i buxhetit vjetor përcakton përdorimin e një suficiti buxhetor apo mënyrat e financimit të një deficitit buxhetor.

Deficiti i Buxhetit të Shtetit financohet nga huat e brendshme ose të huaja.

Buxheti vendor është i balancuar, përveç rasteve kur merret hua për financimin e shpenzimeve kapitale, që shërbejnë për një funksion specifik të njësisë së qeverisjes vendore.

Fondet speciale janë gjithmonë të balancuara dhe nuk mund të kenë deficit.”.

Neni 8

Në nenin 16, paragrafi i parë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet publike, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.”.

Neni 9

Në nenin 18, paragrafi i fundit shfuqizohet.

Neni 10

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

Nëpunësi autorizues

Nëpunës autorizues, në njësitë e qeverisjes qendrore, është punonjësi i administratës publike i nivelit më të lartë të shërbimit civil. Për Ministrinë e Financave, nëpunësi i parë autorizues emëron një punonjës të nivelit të lartë të administratës publike si nëpunës autorizues. Në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që nuk janë pjesë e pushtetit ekzekutiv, nëpunës autorizues është punonjësi i nivelit më të lartë menaxhues. Nëpunës autorizues në njësitë e qeverisjes vendore është kryetari i njësisë, ndërsa zëvendësi i tij është nëpunës autorizues i deleguar, nëse kryetari vendos ta delegojë këtë përgjegjësi. Nëpunësi autorizues i njësisë shpenzuese është titullari i kësaj njësie. Titullari i njësisë së qeverisjes së përgjithshme njofton nëpunësin e parë autorizues për caktimin e nëpunësit autorizues të njësisë së vet.



Nëpunësi autorizues është përgjegjës për menaxhimin financiar në njësinë e qeverisjes së përgjithshme ku është caktuar, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 4, të këtij ligji. Nëpunësi autorizues, në momentin e emërimit, njofton degën përkatëse të thesarit për depozitimin e firmës, lidhur me kryerjen e veprimeve në thesar.

Përgjegjësitë për menaxhimin financiar përfshijnë, por nuk kufizohen me:

a) përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, kontabilitetin dhe raportimin e buxhetit të njësisë së qeverisjes së përgjithshme;

b) sigurimin e përdorimit me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve publike që ai menaxhon.

Nëpunësi autorizues vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nëpunësi autorizues i njësive të qeverisjes qendrore dhe i njësive të fondeve speciale të qeverisjes qendrore raporton dhe përgjigjet përpara nëpunësit të parë autorizues për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar publik, monitorimin, raportimin dhe kontabilitetin e buxhetit të tyre.

Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme cakton nëpunës autorizues të nivelit të dytë drejtuesit e programeve, nënprogrameve, të çdo strukture dhe njësie të vartësisë direkte, për të cilat identifikohet buxhet i veçantë. Në njësitë publike të përshkallëzuara me disa nivele njësisish shpenzuese, nëpunësit autorizues caktohen direkt nga organi epror dhe emërtohen, sipas nivelit të vartësisë, në nëpunës autorizues të nivelit të dytë, të tretë.

Nëpunësi autorizues i njësive të qeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton përpara nëpunësit të parë autorizues për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar publik, monitorimin, raportimin dhe kontabilitetin e buxhetit të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore dhe i fondeve speciale të qeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar publik, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit ose të fondeve

speciale, për të gjitha funksionet e njësive të qeverisjes vendore dhe të fondeve speciale.

Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore mund të caktojë një punonjës të administratës publike si nëpunës autorizues të nivelit të dytë në njësitë e qeverisjes vendore.”

Neni 11

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Nëpunësi zbatues

Nëpunësi zbatues është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat në njësinë e qeverisjes së përgjithshme, i cili plotëson kriteret e posaçme të punësimit dhe mbulon fushat e përgjegjësisë të përcaktuara në legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme, i të gjitha niveleve, në momentin e emërimit të nëpunësit zbatues njofton nëpunësin e parë autorizues dhe degën përkatëse të thesarit për depozitimin e firmës, lidhur me kryerjen e veprimeve në thesar.”

Neni 12

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike dhe buxhetore

Brenda muajit janar, ministri i Financave paraqet, për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, raportin për vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike për:

- a) dy vitet përpara vitit buxhetor;
- b) vitin buxhetor;
- c) tre vitet e ardhshme buxhetore.

Në këtë raport përfshihen:

a) supozimet dhe mënyrat e përdorura për vlerësimin e parashikimin makroekonomik dhe fiskal, përfshirë edhe identifikimin e vlerësimin e riskut për qëndrueshmërinë e stabilitetit makroekonomik të vendit;

b) vlerësimet më të fundit të situatës ekonomike, në bazë të të dhënave zyrtare, si dhe krahasimin me parashikimet e mëparshme;

c) parashikimin për të ardhurat e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të politikave ekzistuese dhe



të propozimeve të politikave të reja apo ndryshimeve të atyre ekzistuese;

ç) parashikimin për shpenzimet e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të politikave ekzistuese dhe propozimeve për politika të reja apo ndryshimeve në politikat ekzistuese;

d) parashikimin për deficitin e qeverisjes së përgjithshme dhe financimin e tij, duke respektuar dhe garantuar disiplinën dhe qëndrueshmërinë fiskale;

dh) informacion të hollësishëm për stokun e borxhit, të brendshëm dhe të jashtëm, për çdo sektor të qeverisjes së përgjithshme.

Këshilli i Ministrave miraton vlerësimin dhe parashikimin makroekonomik dhe ia përcjell Kuvendit brenda datës 10 mars. Me kërkesë të komisionit parlamentar përgjegjës për financat publike, ministri i Financave mund të japë shpjegime para tij për vlerësimet dhe parashikimet e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike të miratuara, ministri i Financave përgatit tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm dhe i dërgon për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave brenda muajit shkurt.”

Neni 13

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Udhëzimi për përgatitjen e buxhetit

Ministri i Financave, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të vlerësimeve dhe parashikimeve makroekonomike e buxhetore, brenda muajit shkurt, miraton dhe dërgon për zbatim në njësitë e qeverisjes së përgjithshme:

1. Udhëzimin për përgatitjen e buxhetit qendror, i cili përmban:

a) tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm;

b) afatet e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe të projektbuxhetit.

2. Udhëzimin për përgatitjen e buxhetit vendor, i cili përmban:

a) transfertat e pakushtëzuara afatmesme për njësitë e qeverisjes vendore;

b) rregullat për ndarjen apo delegimin e funksioneve ndërmjet njësive të qeverisjes qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore;

c) mënyrat e llogaritjes së transfertave, të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara, për njësitë e qeverisjes vendore;

ç) afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.

Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes së përgjithshme përgatisin dhe dorëzojnë kërkesat për programin buxhetor afatmesëm dhe kërkesat shtesë, në përputhje me kërkesat dhe afatet e parashikuara në udhëzimet përkatëse të ministrit të Financave, për përgatitjen e buxhetit.

Të gjitha procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror dhe vendor miratohen me një udhëzim të veçantë të ministrit të Financave.”

Neni 14

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Projekti i programit buxhetor afatmesëm

Ministria e Financave analizon dhe vlerëson kërkesat e buxhetit afatmesëm për secilën njësi të qeverisjes qendrore. Kjo analizë paraqitet në seancat dëgjimore, që organizohen nga Ministria e Financave me secilën njësi të qeverisjes qendrore, sipas një kalendarit të paracaktuar. Ministria e Financave organizon takime me njësitë e qeverisjes vendore për programin buxhetor afatmesëm. Njësia përgjegjëse për buxhetin, në Ministrinë e Financave, zhvillon konsultime me shoqërinë civile në procesin e programimit buxhetor. Pas reflektimit të konkluzioneve të seancave dëgjimore dhe konsultative, nëpunësi i parë autorizues i paraqet projektin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm ministrit të Financave.

Çdo propozim për projekt investimesh publike, që ka një vlerë të plotë mbi një kufi të caktuar, duhet t'i nënshtrohet një procesi të plotë vlerësimi, përpara fillimit të procesit buxhetor. Vlera kufi përcaktohet me udhëzim të ministrit të Financave. Procesi i vlerësimit kryhet nga ministria propozuese e projektit të investimit, sipas procedurave të menaxhimit të investimeve publike, përfshirë kriteret e përparësisë dhe përzgjedhjes së tyre, që propozohen nga Ministria e Financave dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Propozimi përkatës dërgohet për shqyrtim në Ministrinë e Financave, si pjesë integrale e



kërkesave buxhetore, në kuadër të programit buxhetor afatmesëm.

Këshilli i Ministrave, brenda muajit qershor, miraton, me vendim, projektin e programit buxhetor afatmesëm dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve. Ministri i Financave, një kopje të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm, të miratuar, e dërgon për informim në Kuvend dhe, me kërkesë të komisionit kuvendor përgjegjës për financat publike, jep shpjegime në komision për aktin e miratuar.

Nëpunësi i parë autorizues, brenda muajit korrik, njofton çdo njësi të qeverisjes vendore dhe çdo njësi të fondeve speciale të qeverisjes vendore për transfertat nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe pjesën e madhësinë e taksave kombëtare, të ndara në projektbuxhet.”

Neni 15

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Programi buxhetor afatmesëm

Programi buxhetor afatmesëm pasqyron shpërndarjet e buxhetit afatmesëm të njërive të qeverisjes së përgjithshme, të cilat përlogariten në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara në udhëzimin përkatës të ministrit të Financave.

Programi buxhetor afatmesëm përmban:

1. Një përmbledhje të treguesve kryesorë makroekonomikë dhe buxhetorë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave, si pjesë e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm.

2. Një raport përmbledhës të politikave ekonomike dhe fiskale për tre vitet e ardhshme.

3. Një raport të detajuar për kërkesat buxhetore, të paraqitura nga njësitë e qeverisjes qendrore, brenda tavanëve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe për kërkesat shtesë.

4. Tërësinë e dokumentacionit të dërguar nga njësitë e qeverisjes qendrore, sipas formateve standarde, i cili duhet, minimalisht, të përmbajë: qëllimet e politikave të programeve, objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre respektive.

5. Një raport përmbledhës të konkluzioneve të seancave dëgjimore, ndërmjet njërive të qeverisjes qendrore dhe shoqërisë civile, zhvilluar në kuadër të përgatitjes së kërkesave buxhetore.

Dokumenti i programit buxhetor afatmesëm shoqërohet edhe me një aneks, i cili përmban:

a) mënyrën e llogaritjes dhe shumën e transfertës së pakushtëzuar të njërive të qeverisjes vendore;

b) shumën dhe qëllimin e transfertës së kushtëzuar, që Buxheti i Shtetit jep për njësitë e qeverisjes vendore;

c) taksat kombëtare, të ndara me qeverisjen vendore, dhe pjesën e ndarë për tre vitet pasardhëse buxhetore.

Neni 16

Në nenin 27, paragrafi i parë riformulohet si më poshtë:

“Pas miratimit, nga Këshilli i Ministrave, të tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, ministri i Financave, brenda datës 10, të muajit korrik, nxjerr:

1. Udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit qendror, i cili përfshin:

a) tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) afatet për rishikimin e kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, në bazë të tavanëve përfundimtare të shpenzimeve.

2. Udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit vendor, i cili përfshin:

a) transfertat e pakushtëzuara afatmesme, të rishikuara, për njësitë e qeverisjes vendore;

b) rishikimet e mundshme të rregullave për ndarjen apo delegimin e funksioneve, ndërmjet njërive të qeverisjes qendrore dhe njërive të qeverisjes vendore;

c) rishikimet e mundshme të mënyrave të llogaritjes së transfertave, të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara, për njësitë e qeverisjes vendore;

ç) afatet për rishikimin e kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.”

Neni 17

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

Projektbuxheti vjetor

Ministri i Financave i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave projektbuxhetin vjetor, me tavanë trevjeçare, mbi bazën e programit buxhetor



afatmesëm, bashkë me programin buxhetor afatmesëm, të rishikuar, siç përcaktohet në nenin 28, të këtij ligji. Projektbuxheti vjetor përmban dokumentacionin bazë dhe dokumentacionin shoqërues si më poshtë:

1. Dokumentacioni bazë:

a) fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore, për vitin e ardhshëm, të ndara në korrente dhe kapitale;

b) tavanet për çdo program, për vitin e dytë dhe të tretë të PBA-së;

c) një tabelë përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme fiskale dhe tre vitet e ardhshme;

ç) numrin e punonjësve buxhetorë, për çdo njësi të qeverisjes qendrore, për vitin e ardhshëm;

d) transfertën e pakushtëzuar për çdo njësi të qeverisjes vendore, për vitin e ardhshëm, vetëm totalin e transfertës, për vitin e dytë dhe të tretë të PBA-së.

2. Dokumentacioni shoqërues:

a) informacion të detajuar për shpenzimet, sipas klasifikimeve buxhetore;

b) listën e projekteve të investimeve publike, për çdo program, e cila përmban:

i) koston e plotë të projekteve;

ii) vlerën e financuar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës;

iii) vlerën e parashikuar për t'u financuar në vitin buxhetor;

iv) vlerën e mbetur për t'u financuar në vitet pasardhëse buxhetore;

v) burimet e financimit;

c) një shpjegim për qëllimin dhe kostot e veprimtarive pothuajse fiskale, të ndërmarra nga njësitë jo të qeverisjes së përgjithshme, si dhe një parashtrim të shpenzimeve të taksave;

ç) listën e njërive shpenzuese, sipas njërive të qeverisjes së përgjithshme nga të cilat varen;

d) objektivat kryesorë të programeve për çdo njësi të qeverisjes qendrore;

dh) respektimin dhe zbatimin korrekt të parimeve të parashikuara në nenin 4 dhe 4/1, të këtij ligji, në projektbuxhetin e paraqitur;

e) parashikimet për borxhin publik dhe harmonizimin me objektivat e qëndrueshmërisë fiskale;

ë) risqet fiskale dhe masat mbrojtëse;

f) detyrimet kontingjente të qeverisjes së përgjithshme dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës;

g) listën e plotë të projekteve koncesionare/PPP në vazhdim, vlerën totale të kontraktuar të investimit dhe implikimet buxhetore për çdo projekt.

Brenda datës 15 tetor, Këshilli i Ministrave miraton, me vendim, projektbuxhetin vjetor dhe programin buxhetor afatmesëm, të rishikuar.

Nëpunësi i parë autorizues, brenda 10 ditëve, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të buxhetit vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm, të rishikuar, njofton çdo njësi të qeverisjes vendore dhe çdo njësi të fondeve speciale të qeverisjes vendore për transfertat nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe pjesën e madhësinë e taksave kombëtare, të ndara në projektbuxhet.

Brenda datës 20 tetor, Kryeministri, në emër të Këshillit të Ministrave, i paraqet Kuvendit projektbuxhetin vjetor.

Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave publikon informacionin e plotë të projektbuxhetit vjetor.”.

Neni 18

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30

Miratimi i projektligjit të buxhetit vjetor

Projektligji i buxhetit vjetor miratohet nga Kuvendi, brenda datës 15 dhjetor, sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” e “d”, të pikës 1, të nenit 29, të këtij ligji.

Këshilli i Ministrave mund të propozojë miratimin e buxhetit vjetor nga Kuvendi edhe në nivel më të detajuar, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 4, të këtij ligji.”.

Neni 19

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore

Njësitë e qeverisjes vendore hartojnë e miratojnë buxhetin vendor dhe programin buxhetor afatmesëm. Procedurat dhe afatet e hartimit të programit buxhetor afatmesëm përcaktohen me udhëzime të ministrit të Financave.



Për funksione dhe kompetenca që ndërthuren me ato të qeverisjes qendrore, organet e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me ministrinë dhe institucionet buxhetore. Detajet dhe mënyra e bashkëpunimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për çështjet vendore.

Si rregull, brenda muajit nëntor të vitit buxhetor, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore paraqesin për miratim buxhetet në këshillat e tyre.

Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 25 dhjetor, miraton buxhetin vendor, në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor.”.

Neni 20

Neni 37 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 37

Buxhetet e përkohshme vendore

Në rast të mosmiratimit, nga këshilli i njësive të qeverisjes vendore, të buxhetit vendor, deri në ditën e parë të vitit buxhetor, kryetari i njësive të qeverisjes vendore autorizon të kryhen, çdo muaj, shpenzime deri në 1/12 e shpenzimeve faktike të buxhetit vendor (nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta të njësive vendore) në vitin buxhetor paraardhës, për të siguruar vazhdimin e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, përfshirë zbatimin e projekteve të investimeve, të filluara në vitin buxhetor paraardhës dhe që vazhdojnë në vitin buxhetor. Fondet nga transfertat e kushtëzuar, grantet apo projektet specifike financohen tërësisht, sipas destinacionit të institucionit që i akordon.”.

Neni 21

Neni 40 riformulohet si më poshtë:

“Neni 40

E drejta për të kryer shpenzime

Si rregull, e drejta për të kryer shpenzime, brenda kufirit të fondeve të miratuara, skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës. Për fondet e njësive vendore, nga transfertat e pakushtëzuar apo të ardhurat vendore, e drejta për të kryer shpenzime është në përputhje me përcaktimet e ligjit përkatës për vetëqeverisjen vendore.

Ministri i Financave përcakton një sistem rregullash dhe procedurash për të kontrolluar që angazhimet shumëvjeçare të jenë brenda tavaneve trevjeçare, të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit.

Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre nuk lejohet që në buxhetin e njësive përkatëse të qeverisjes së përgjithshme të shpërndahen më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës.

Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria e Financave që fondet, të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë direkt në sistemin informatik financiar të Qeverisë, për ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe raportimin financiar regjistrojnë në këtë sistem angazhimin, brenda pesë ditëve pune nga data e nënshkrimit të tij, kundrejt urdhrat të prokurimit.

Përcaktimi i limiteve trevjeçare të angazhimeve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme bëhet në përputhje me parimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik. Limiti i angazhimeve për njësitë e qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të këshillit të njësive vendore dhe regjistrohet në sistemin informatik financiar të Qeverisë.”.

Neni 22

Neni 41 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 41

Informimi për fondet e miratuara nga Kuvendi

Brenda 10 ditëve, nga publikimi në Fletoren Zyrtare të ligjit të buxhetit vjetor, nëpunësi i parë autorizues informon, me shkrim, nëpunësit autorizues të çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme për fondet e miratuara nga Kuvendi në ligjin e buxhetit vjetor.”.

Neni 23

Në nenin 46, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Në muajin qershor të çdo viti, por jo më vonë se dita e paraqitjes së programit buxhetor afatmesëm në Këshillin e Ministrave, ministri i



Financave paraqet përpara Këshillit të Ministrave programin buxhetor afatmesëm dhe një raport për zbatimin e buxhetit të vitit në vazhdim, i cili publikohet. Ky raport përmban:

a) një vlerësim të përgjithshëm të situatës ekonomike të vendit, të treguesve makroekonomikë, fiskalë dhe buxhetorë për periudhën 5-mujore të vitit korrent;

b) një vlerësim të pritshëm të treguesve makroekonomikë, fiskalë dhe buxhetorë deri në fund të vitit korrent;

c) masat që parashikohen të ndërmerren nga Qeveria, me qëllim që treguesit të realizohen sipas parashikimeve;

ç) propozimin e ministrit të Financave për rishikimin apo jo të buxhetit.”

Neni 24

Në nenin 51, pas paragrafit të tretë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor.”

Neni 25

Në nenin 52, pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.”

Neni 26

Neni 53 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 53

Rimbursimi i shpenzimeve

Nëse gjatë vitit buxhetor korrent njëria shpenzuese e qeverisjes së përgjithshme merr një rimbursim për një shumë që është paguar në atë vit buxhetor ose në vitet buxhetore paraardhëse, atëherë rimbursimi trajtohet si arkëtim në vitin buxhetor korrent.

Shpenzimet e paguara gjatë vitit korrent dhe të rimbursuara gjatë po të njëjtut vit korrektohen me strukturën buxhetore, në të cilën është shpërndarë rimbursimi respektiv i arkëtuar.

Faqe | 8200

Fondet e çliruara nga korrektimi në strukturën buxhetore fillestare mund të përdoren për kryerjen e shpenzimeve të tjera, në përputhje me objektivat e njësisë shpenzuese.”

Neni 27

Neni 54 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 54

Kryerja e pagesave

Angazhimet dhe detyrimet financiare të njërive të qeverisjes së përgjithshme paguhen vetëm nga llogaria e unifikuar e thesarit, nëpërmjet sistemit informatik financiar të Qeverisë, nga personat e caktuar sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Nëpunësi autorizues i njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, të cilat janë përdoruese të drejtpërdrejta të sistemit informatik financiar të Qeverisë, miraton transaksionet e regjistruara nga nëpunësi zbatues i njësisë brenda 5 ditëve, nga data e regjistrimit të tyre në sistem.

Nëse përfituesi është njësi që operon me sistemin e thesarit, atëherë transaksioni procesohet me anë të kontabilizimeve në sistem, pa lëvizje të mjeteve monetare që prekin llogarinë e unifikuar të thesarit.

Transaksionet e shpenzimeve që rrjedhin nga angazhimet financiare procesohen të përputhura me urdhrat e blerjes, të regjistruara më parë në sistemin e thesarit.

E drejta për të kryer pagesa për detyrime financiare, të konstatuara deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, skadon në fund të muajit janar të vitit pasardhës, pavarësisht nëse detyrimi financiar paraqitet në sistemin e thesarit në vitin buxhetor pasardhës, duke respektuar afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

Pagesat e kryera gjatë vitit buxhetor, pavarësisht kohës së konstatimit të detyrimit financiar, regjistrohen si pagesa të këtij viti.

Pagesat e kthyera për llogari të detyrimeve financiare të vitit paraardhës, të cilat nuk do të ripaguhen, do të trajtohen si arkëtim në vitin ushtrimor.”

Neni 28

Neni 57 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 57

Autoriteti për të marrë hua

Ministri i Financave, në emër të Këshillit të Ministrave ose Republikës së Shqipërisë, është i vetmi autoritet, në nivel qendror, që ka të drejtën e marrjes së huave, në emër të Republikës së Shqipërisë ose Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet instrumenteve financiare dhe marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, për të financuar deficitin buxhetor të shtetit, mungesën e përkohshme të likuiditetit, rifinancimin e borxhit shtetëror, për të paguar garancitë shtetërore, koston e emetimit të borxhit shtetëror, për të përballuar koston e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore, si dhe për financimin e projekteve, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe me ligjet në fuqi. Ai është i vetmi autoritet që jep garanci shtetërore të huas.

Ministri i Financave është autoriteti që negocion e vendos për kushtet thelbësore të marrëveshjeve të huas dhe nënshkruan këto marrëveshje, në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave.

Ministri i Financave është autoriteti që emeton instrumentet e huas dhe ka të drejtën e zgjedhjes së llojit të instrumenteve, të karakteristikave e kushteve të tyre.

Ministri i Financave është autoriteti që ka të drejtën e marrjes së huave, brenda limiteve të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor, nga persona juridikë dhe/ose fizikë.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore është autoriteti që ka të drejtën e marrjes së huave dhe dhënien e garancive, brenda dhe jashtë vendit, për huan vendore.

Huaja afatgjatë vendore dhe garancitë miratohen, paraprakisht, nga Ministri i Financave, lidhur me procedurat, limitet dhe efektet e saj.”

Neni 29

Neni 58 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 58

Kufijtë e borxhit publik

Borxhi publik përbëhet nga borxhi i qeverisjes qendrore, garancitë shtetërore të huas dhe borxhi i qeverisjes vendore. Në ligjin e buxhetit vjetor vendoset kufiri, për:

a) borxhin e ri të qeverisjes qendrore, për t’u marrë në vitin buxhetor;

b) totalin e borxhit të qeverisjes qendrore;

c) garancitë e reja për t’u lëshuar gjatë vitit buxhetor, nga Qeveria qendrore;

ç) totalin e shumës së garancive të qeverisjes qendrore;

d) borxhin e emetuar për të mbuluar humbjet e bankës qendrore nga rivlerësimi i valutave.

Njësitë e qeverisjes vendore marrin hua dhe lëshojnë garanci në rastet kur:

a) raporti i tepricës operative të vitit fiskal paraardhës (të llogaritur si diferenca e të ardhurave operative, nga burimet e veta, taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuar me shpenzimet jo të kushtëzuara operative të njësisë së qeverisjes vendore) me shërbimin e borxhit, që duhet të paguhet çdo vit për borxhin afatgjatë, është jo më pak se 1,4:1;

b) raporti i stokut të borxhit ndaj të ardhurave operative, gjithsej (nga burimet e veta, taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuar), është jo më shumë se 1,3:1;

c) kufiri maksimal vjetor i shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave mesatare (transfertat e pakushtëzuar, taksat dhe tatimet e ndara dhe taksat dhe tarifatat vendore) të tre viteve fiskale paraardhëse të njësisë së qeverisjes vendore nuk e kalon masën 20 për qind.”

Neni 30

Neni 59 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 59

Menaxhimi i të dhënave të huave

Ministri i Financave është përgjegjës për evidentimin, regjistrimin dhe menaxhimin e të gjitha huave të qeverisjes qendrore, garancive shtetërore në regjistrin e borxhit publik.

Ministri i Financave është përgjegjës për evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha huave vendore, garancive vendore në regjistrin e borxhit publik.

Ministri i Financave miraton formatin dhe afatin e raportimit të të dhënave të borxhit publik nga njësitë e qeverisjes vendore.”

Neni 31

Neni 61 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 61

Standardet dhe procedurat e kontabilitetit

Ministri i Financave është përgjegjës për krijimin e sistemit të kontabilitetit, i detyrueshëm për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Ministria e Financave harton standardet e kontabilitetit publik dhe raportimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar, aktet nënligjore dhe metodologjinë në fushën e kontabilitetit publik, të cilat miratohen nga Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Detyrat, përbërja dhe mënyra e funksionimit e organizimit të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik përcaktohen në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në shqyrtimin e çështjeve të kontabilitetit publik, fton të marrin pjesë, si vëzhgues, në takim edhe përfaqësues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucioni përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, gjatë shqyrtimit të standardeve, akteve nënligjore dhe metodologjisë në fushën e kontabilitetit publik, duhet të analizojë mundësitë dhe kushtet e zbatimit në praktikë të tyre.

Sistemi i thesarit është përgjegjës për mbajtjen e llogarive të shtetit dhe përgatitjen e raporteve periodike e vjetore të zbatimit të buxhetit, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme.

Nëpunësi i parë autorizues dhe nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes së përgjithshme përgjigjen për funksionimin dhe zbatimin e sistemit të kontabilitetit, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të tij, të nxjerra nga Ministri i Financave.

Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me:

a) njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës;

b) njohjen e të ardhurave në çastin e arkëtimit të tyre.”

Neni 32

Neni 63 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 63

Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit

Këshilli i Ministrave, brenda muajit qershor, miraton dhe përcjell në Kuvend raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit, i cili përmban:

a) pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit;

b) raportin për zbatimin e buxhetit vjetor, në nivelin e fondeve të miratuara dhe objektivave të realizuar;

c) raportin për borxhin publik dhe përbërjen e tij;

ç) raportin për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës;

d) raportin për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme;

dh) çdo raportim tjetër financiar, të kërkuar nga Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit, i miratuar nga Këshilli i Ministrave, publikohet nga Ministria e Financave, brenda muajit qershor të çdo viti.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit shqyrton dhe certifikon pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit dhe i paraqet Kuvendit një raport të plotë për zbatimin e buxhetit të vitit të mëparshëm fiskal.

Ministri i Financave, gjatë procesit të shqyrtimit të raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit nga Kuvendi, raporton me hollësi të ky i fundit lidhur me nivelin e realizimit të fondeve buxhetore në dispozicion dhe objektivave të synuar me ligjin vjetor të buxhetit paraardhës.

Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit miratohet nga Kuvendi, brenda muajit tetor të çdo viti buxhetor, dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.”

Neni 33

Neni 65 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 65

Monitorimi

Nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes qendrore i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet



dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm. Për njësitë e qeverisjes vendore, këto raporte paraqiten në këshillin përkatës.

Forma, përmbajtja dhe afatet e raporteve të monitorimit përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave.

Ministri i Financave i paraqet për informim Këshillit të Ministrave një përmbledhje të raporteve të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit, sa herë që kërkohet.

Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore i paraqet për informim këshillit përkatës një kopje të raportit të monitorimit e të zbatimit të buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore.

Raportet e monitorimit e të zbatimit të buxhetit publikohen nga nëpunësi autorizues në faqen zyrtare të ministrisë përkatëse, brenda një muaji pas përfundimit të periudhës së raportimit. Komentet e ministrisë përgjegjëse për financat publikohen nga nëpunësi i parë autorizues në faqen zyrtare të saj.

Ministri i Financave, sa herë që kërkohet, paraqet në komisionin përkatës kuvendor raporte periodike, pasqyra financiare dhe raportin vjetor për zbatimin e buxhetit në Republikën e Shqipërisë. Me kërkesë të komisionit, ai raporton gjatë vitit edhe për çështje të tjera, që kanë lidhje me zbatimin e buxhetit dhe kontrollin e brendshëm financiar publik.”

Neni 34

Neni 66 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 66

Kontrolli i brendshëm financiar publik

Ministri i Financave është përgjegjës për bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e kontrollit të brendshëm financiar publik, për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i cili përfshin:

a) një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit, fushë, e cila, në sektorin publik, rregullohet me ligj të veçantë;

b) funksionin e decentralizuar të auditimit të brendshëm, si një veprimtari e pavarur funksionalisht, që raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike. Auditimi i brendshëm në sektorin publik rregullohet me ligj të veçantë;

c) strukturën përgjegjëse të harmonizimit në Ministrinë e Financave, për harmonizimin dhe

bashkërendimin e zbatimit e të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik.

Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të një funksioni të pavarur të auditimit të brendshëm.”

Neni 35

Neni 69 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 69

Inspektimi financiar

Çdo parregullsi, keqmenaxhim i rëndë financiar, marrje përsipër e angazhimeve jashtë fondeve të parashikuara në buxhet apo pagesa në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi përbëjnë elemente për fillimin e inspektimit financiar publik.

Parimet, rregullat, procedurat dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave të përfshira në procesin e inspektimit financiar publik rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 36

Në nenin 71, pas shkronjës “ë”, shtohen shkronjat “f”, “g” dhe “gj” me këtë përmbajtje:

“f) kur nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme nuk respekton afatet e përcaktuara në nenin 40, të këtij ligji, për regjistrimin e angazhimeve shumëvjeçare buxhetore në sistemin informatik financiar të Qeverisë, ai dënohet me gjobë nga nëpunësi i parë autorizues, në masën nga 1 deri në 3 paga mujore;

g) kur nëpunësi zbatues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme nuk respekton afatet e përcaktuara në nenin 52, të këtij ligji, lidhur me dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, ai dënohet me gjobë nga nëpunësi i parë autorizues, në masën nga 3 deri në 7 paga mujore;

gj) kur nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme nuk respekton afatet e përcaktuara në nenin 54, të këtij ligji, lidhur me miratimin e transaksioneve të regjistruara nga nëpunësi zbatues i njësisë në sistemin informatik financiar të Qeverisë, ai dënohet me gjobë nga nëpunësi i parë autorizues, në masën nga 3 deri në 7 paga mujore.”



Neni 37
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të paragrafit të dytë, të nenit 25, të këtij ligji;

Ngarkohet ministri i Financave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 25, paragrafi i dytë; 26, paragrafi i parë; 32, paragrafi i parë; dhe 65, paragrafi i dytë, të këtij ligji.

Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për çështjet vendore që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 32, paragrafi i dytë, të këtij ligji.

Neni 38

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.6.2016

Shpallur me dekretin nr. 9637, datë 14.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 58/2016

PËR RATIFIKIMIN E DOKUMENTIT TË NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË HUAS, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 89/2013, “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË BURIMEVE UJORE DHE UJITJES”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet dokumenti i ndryshimit të marrëveshjes së huas, të ratifikuar me ligjin nr. 89/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.6.2016

Shpallur me dekretin nr. 9638, datë 14.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Banka Botërore BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM	1818 H Street N.W. Washington, D.C. 20433 SH.B.A.	(202) 473-1000 Adresa Kablore Adresa kabllore: INDEVAS INTBAFRAD _____2016
--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------

Sh.T.Z Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit
Nr. 4, Tiranë
Republika e Shqipërisë

Lënda: Republika e Shqipërisë: Projekti për Burimet Ujore dhe Ujitjen (Numri i Huas 8211-AL) Ndryshim i Marrëveshjes së Huas

Shkëlqesi:

Me anë të kësaj shkrese i referohemi Marrëveshjes së Huas (Marrëveshja) të datës 14 dhjetor 2012 ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore). Në përgjigje të shkresës suaj drejtuar, Bankës Botërore më 8 shtator 2015, Banka Botërore propozon ndryshimin e Marrëveshjes si më poshtë:

1. Seksioni 3.01 i Marrëveshjes ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:



“Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi realizon Projektin nëpërmjet MBZHRAU-së në përputhje me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme”.

2. Seksioni 4.01 (a) ndryshon duke hequr fjalët “komiteti i cili bashkëdrejtohet nga ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, i cili do të jetë përgjegjës për: sigurimin e koordinimit ndërinstitucional” dhe zëvendësohet me “komiteti që drejtohet nga ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, i cili do të jetë përgjegjës për sigurimin e koordinimit institucional.”

3. Seksioni I.A.1(b) i pjesës 2 të Marrëveshjes hiqet plotësisht dhe ish-seksioni I.A.1(c) rinumërohet si seksioni I.A.1(b).

4. Seksioni 1.A.1(c) i pjesës 2 të Marrëveshjes ndryshohet duke fshirë fjalët “brenda MBUMK-së dhe MMPAU-së” dhe duke i zëvendësuar ato me “brenda MBZHRAU-së”.

5. Fjalët “dhe MMPAU” hiqen në seksionet vijuese të pjesës 2 të Marrëveshjes:

- (i) Seksioni 1.C.1;
- (ii) Seksioni 1.C.3;
- (iii) Seksioni 1.C.4;
- (iv) Seksioni 1.C.5;
- (v) Seksioni II.A.1;
- (vi) Seksioni II.B.2; dhe
- (vii) Seksionet V.1.

6. Seksioni V.2 i pjesës 2 të Marrëveshjes

ndryshon duke hequr fjalët “ndërmjet MF-së, MBUMK-së dhe MMPAU-së” dhe duke i zëvendësuar me “ndërmjet MF-së dhe MBZHRAU-së”.

7. Seksioni i shtojcës (“Përkufizime”) të Marrëveshjes ndryshon si vijon:

a) Paragrafi 12 hiqet plotësisht dhe zëvendësohet me sa më poshtë: “MBZHRAU” do të thotë Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave e Huamarrësit.” Rrjedhimisht, të gjitha referencat për “MBUMK-në” në Marrëveshje ndryshojnë mutatis mutandis dhe bëhen “MBZHRAU”.

b) Paragrafi 13 hiqet plotësisht dhe ish paragrafët 14–22 rinumërohen si paragrafët 13–21.

c) Shtohet një paragraf i ri 22 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Trajnim” do të thotë shpenzime (përveç shërbimeve të konsulencës) të kryera gjatë zbatimit të Projektit bazuar në buxhetin periodik të pranueshëm për Bankën, për: i) shpenzime udhëtimi, akomodimi, ushqimi dhe për diem të kryera nga trajnuesit dhe të trajnuarit në lidhje me trajnimin e tyre; ii) tarifa të kursit; iii) ambientin e trajnimit/seminarit dhe marrjen me qira të pajisjeve; dhe iv) shpenzime për përgatitjen e materialeve të trajnimit, blerjen, riprodhimin dhe shpërndarjen”.

8. Tabela në seksionin IV të pjesës 2 të Marrëveshjes ndryshon si më poshtë:

Kategoria	Shuma e huas (në euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshijë taksat)
1. Mallra, punime, shërbime jokonsulente, shërbime konsulente dhe trajnim, për:		
a) Pjesën 3 të Projektit (përveç mallrave për pjesën 3(c);	48.411	100%
b) Pjesë të tjera të Projektit;	30.006.527	100%
c) Mallra për pjesën 3(c) të Projektit.	240.000	45%
2. Kosto operative rritëse	220.000	100%
3. kthimin e pagesës së përgatitjes së Projektit	407.562	Shuma e pagueshme sipas seksionit 2.07(a) të Kushteve të Përgjithshme
4. Tarifa “fillestare”	77.500	Shuma e pagueshme sipas seksionit 2.03 të Marrëveshjes në përputhje me seksionin 2.07(b) të Kushteve të Përgjithshme
GJITHSEJ	31.000.000	



9. Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes të cilat nuk kanë ndryshuar, mbeten të pandryshuara dhe në fuqi.

Ju lutem, konfirmoni pëlqimin e Huamarrësit për sa më sipër duke nënshkruar dhe vendosur datën dhe më pas na dërgoni kopjen e kësaj shkrese ndryshimi. Kjo shkrese ndryshimi hyn në fuqi nga data në të cilën Banka Botërore i dërgon Huamarrësit njoftimin e pranimit të saj që ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj shkrese ndryshimi është autorizuar ose ratifikuar siç duhet me anë të të gjithë hapave të nevojshëm qeveritarë.

Me respekt,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____
Ellen Goldstein
Drejtoreshë për vendin, Evropa Juglindore
Evropa dhe Azia Qendrore

MIRATUAR:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga _____
Përfaqësues i Autorizuar
Emri: _____
Titulli: _____
Data: _____

Ndryshimi i shkresës plotësuese nr.2

SHQIPËRIA:

Data: _____

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Lënda: Hua nr. 8211-AL
(Projekti për Burimet Ujore dhe Ujitjen)
Treguesit e rishikuar të Monitorimit të Performancës

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Në këtë shkrese i referohemi paragrafit A.1 të seksionit II të pjesës 2 të Marrëveshjes së Huas, datë 14 dhjetor 2012, ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka). Huamarrësi, me anë të kësaj shkrese, i konfirmon Bankës që treguesit e përcaktuar në pjesën bashkëlidhur kësaj shkrese do të shërbejnë si bazë për Huamarrësin që të monitorojë dhe të vlerësojë ecurinë e Projektit dhe përmbushjen e objektivave të tij.

Me respekt,

SHQIPËRIA:

Nga _____
Përfaqësuesi i Autorizuar



Huaja nr. 8211-AL
(Projekti për burimet ujore dhe ujitjen)
Treguesit e rishikuar të monitorimit të performancës

Objektivat e Zhvillimit të Projektit

Objektivi i Zhvillimit të Projektit (OZHP) është: i) krijimi i kuadrit strategjik për të menaxhuar burimet ujore në nivel kombëtar dhe në nivelin e basenit ujor të Drinit-Bunës dhe Semanit; dhe ii) përmirësimin në mënyrë të qëndrueshme të performancës së Sistemeve të Përzgjedhura të Ujitjes.

Treguesit objektivë të zhvillimit të Projektit

Emri i treguesit	Komponenti kryesor	Njësia e matjes	Pikënisja	Vlerat kumulative të synuara					Shpeshtësia	Burimi i të dhënave/ Metodologjia	Përgjegjës për Mbledhjen e të dhënave
				Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Objektivi përfundimtar			
Përgatitja e një strategjie të miratuar për MIBU-në		Po/Jo	Jo			Jo	Po	Po	Vjetor	Nuk ka	EMP
Përgatitja e dy planeve MBL për basenin Drin-Buna dhe Seman		Po/Jo	Jo			Jo	Jo	Po	Vjetor	Nuk ka	EMP
Përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit (*) (përdoruesit e ujit) (treguesi kyç)	<input checked="" type="checkbox"/>	Numri	0.00	0.00	0.00	0.00	30000	40000	Vjetor	Sistemi M&V i bazuar në vizitat në terren (numri i synuar do të konfirmohet nga studimi bazë që do të zhvillohet për skemën e ujitjes).	EMP mbështetet nga konsulentët e M&V dhe të sigurisë
Përfitueset femra (plotësues, treguesi kyç)	<input checked="" type="checkbox"/>	Përqindja	0.00	0.00	0.00	0.00	50	50	Vjetor	Sistemi M&V bazuar në vizitat në terren	EMP mbështetet nga konsulentët e M&V dhe të sigurisë



Treguesit e rezultateve të ndërmjetme

Emri i treguesit	Komponenti kryesor	Njësia e matjes	Pikënisja	Vlerat kumulative të synuara					Shpeshtësia	Burimi i të dhënave/metodologjia	Përgjegjës për mbledhjen e të dhënave
				Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Objektivi përfundimtar			
Numri i digave të rehabilituara në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë së digave		Numri	0	0	0	5	10	11	Vjetor	Nuk ka	EMP
Zonës i ofrohen shërbime ujëteje dhe kullimi (Bërthama)	<input checked="" type="checkbox"/>	Hektarë	0	0	0	0	15.000	20.000 (për t'u përcaktuar sipas projekteve të zbatimit në proces)	Vjetor	Sistemi M&V bazuar në vizitat në terren (Komponenti 4)	EMP mbështetet nga konsulentët e M&V dhe të sigurisë
Përgatitja e një strategjie të miratuar për ujëtejen		Po/Jo	Jo			Po	Po	Po	Vjetor	Nuk ka	EMP
Krijimi i një baze të dhënash funksionale për burimet ujore		Po/Jo	Jo			Jo	Po	Po	Vjetor	Nuk ka	EMP
Pjesa e zonës ku ofrohen shërbimi ujëteje dhe kullimi, në të cilën prezantohen rregullime të qëndrueshme të ndarjes së koston dhe rregullime O&M		Përqindja	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	80,00	Vjetor	Sistemi M&V bazuar në vizitat në terren	EMP mbështetet nga konsulentët e M&V dhe të sigurisë

(*) Pas përfundimit të studimit bazë, numri i saktë i synuar do të shkruhet në Manualin e përditësuar Operacional të Projektit.

**Treguesit objektivë të zhvillimit të Projektit**

Emri i treguesit	Përshkrimi (përkufizim i treguesit etj.)
Përgatitja e një strategjie të miratuar për MIBU (Po/Jo)	Strategjia MIBU është pranuar dhe përgatitur
Përgatitja e dy planeve MBL për basenin Drin-Buna dhe Seman (Po/Jo)	Dy plane MBL për basenin Drin-Buna dhe Seman janë pranuar dhe përgatitur
Përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit (Numri) - (Bërthamë)	Numri i përdoruesve të ujit që përfitojnë nga investimi për rehabilitimin dhe përmirësimin e digave, ujitjen. Përkufizimi i treguesit thelbësor: Përfitues të drejtpërdrejtë janë personat ose grupet që përfitojnë direkt nga një ndërhyrje. Ju lutemi të vëreni që treguesi kërkon informacion shtesë. Vlera plotësuese: Përfitueset femra (përqindja). Bazuar në vlerësimin dhe përkufizimin e përfituesve të drejtpërdrejtë të projektit, specifikoni përqindjen e përfituesve të drejtpërdrejtë të projektit që janë femra. Ky tregues llogaritet si përqindje.
Përfitueset femra (Përqindje- Nëntip: Plotësues) - (Bërthamë)	Bazuar në vlerësimin dhe përkufizimin e përfituesve të drejtpërdrejtë të projektit, specifikoni përqindjen e përfituesve femra.

Treguesit e Rezultateve të Ndërmjetme

Emri i treguesit	Përshkrimi (përkufizim i treguesit etj.)
Numri i digave të rehabilituara në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë së digave (Numri)	Digat janë rehabilituar në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë së digave
Zonës i ofrohen shërbime ujitjeje dhe kullimi (ha)	Ky tregues mat sipërfaqen totale të tokës ku ka shërbim ujitjeje dhe kullimi sipas projektit, përfshirë: i) zonën ku ka shërbime të reja të ujitjes dhe kullimit; dhe ii) zonën ku ka shërbime të përmirësuara të ujitjes dhe kullimit, të shprehura në hektarë (ha).
Përgatitja e një strategjie të miratuar për ujitjen (Po/Jo)	Strategjia e ujitjes është pranuar dhe përgatitur
Krijimi i një baze funksionale të dhënash për burimet ujore	Baza funksionale e të dhënave për burimet ujore është krijuar
Pjesa e zonës ku ofrohen shërbime ujitjeje dhe kullimi, në të cilën prezantohen rregullime të qëndrueshme të ndarjes së kostos dhe rregullime O&M	Pjesa e zonës ku ofrohen shërbime ujitjeje dhe kullimi, në të cilën prezantohen rregullime të qëndrueshme të ndarjes së kostos dhe rregullime O&M tregohet me përqindje.



LIGJ
Nr. 59/2016

**PËR RATIFIKIMIN E VENDIMIT TË
KOMISIONIT TË PËRBASHKËT
TË MARRËVESHJES SË TREGTISË SË
LIRË TË EVROPËS QENDRORE NR.
3/2015, PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT
TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT
TË MARRËVESHJES SË TREGTISË SË
LIRË TË EVROPËS QENDRORE 3/2013,
NË LIDHJE ME ANEKSIN 4, TË
MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË
TË EVROPËS QENDRORE (CEFTA 2006),
PROTOKOLLI PËR PËRKUFIZIMIN
E KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE TË
ORIGINËS” DHE METODAVE
TË BASHKËPUNIMIT
ADMINISTRATIV, TË REFERUARA NË
NENIN 14, PARAGRAFËT 1 E 3**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet vendimi i Komisionit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore nr. 3/2015, për ndryshimin e vendimit të Komisionit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore 3/2013, në lidhje me aneksin 4, të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA 2006), protokollin për përkufizimin e konceptit të “Produkteve të origjinës” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, të referuara në nenin 14, paragrafët 1 e 3, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.6.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9639, datë 14.6.2016
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Faqe | 8210

**VENDIMI I KOMISIONIT TË
PËRBASHKËT TË MARRËVESHJES SË
TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS
QENDRORE**

Nr. 3/2015

Amendim i vendimit të Komisionit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore 3/2013 në lidhje me aneksin 4 të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA 2006), protokollin për përkufizimin e konceptit të “produkteve të origjinës” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, të referuara në nenin 14, paragrafët 1 dhe 3

Miratuar më 20 nëntor 2013

Komisioni i Përbashkët,

Duke pasur parasysh Marrëveshjen për amendimin dhe zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA 2006), (më poshtë e referuar si “Marrëveshja”), të lidhur në Bukuresht, më 19 dhjetor 2006, në veçanti, nenin 14 të CEFTA 2006 mbi Rregullat e Origjinës dhe Bashkëpunimit në Administratën Doganore,

Duke pasur parasysh aneksin 4 të CEFTA 2006, protokollin në lidhje me përkufizimin e konceptit të “produkteve të origjinës” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, të referuar më poshtë si “protokollin”,

Duke marrë parasysh se:

1. Neni 14 i CEFTA 2006 i referohet aneksit 4 të tij, i cili parashtron rregullat e origjinës dhe i ofron CEFTA-s akumulimin e origjinës dhe akumulimin e origjinës në kontekstin e Procesit të Stabilizim Asociimit.

2. Protokollin është amenduar së fundi me vendimin nr. 3/2013 të Komisionit të Përbashkët të 20 nëntorit 2013 për të amenduar aneksin 4 të CEFTA 2006, në lidhje me përkufizimin e konceptit të produkteve të origjinës dhe metodave të bashkëpunimit administrativ për t’iu referuar Konventës Rajonale mbi Rregullat Preferenciale Pan-euro-mesdhetare të Origjinës¹ (më poshtë referuar si “Konventa”).

3. Të gjithë pjesëmarrësit në procesin e stabilizim asociimit janë përfshirë në zonën pan-

¹ Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian L 54, 26.2.2013, f. 4.



euro-mesdhetare të akumulimit të origjinës nëpërmjet Konventës;

4. Palët kontraktuese të Konventës nuk detyrohen nga Konventa të hyjnë në marrëveshje dypalëshe. Këto dispozita të veçanta mbi përjashtime janë të përcaktuara në anekset e shtojcës II të Konventës. I duhet kushtuar vëmendje nevojës për transparencë, përfshirë përshtatjen për ndryshim të procedurës për amendim ose plotësim të shtojcës II të Konventës.

5. Kur tranzicioni drejt Konventës nuk është i njëhershëm për të gjitha Palët Kontraktuese brenda zonës akumuluese dhe nuk duhet të çojë në rrethana më pak të favorshme se para protokollit, ka vendosur si më poshtë:

Neni 1

Rregullat e origjinës

Aneksi i vendimit 3/2013 zëvendësohet me aneksin e këtij vendimi, i cili përmban dy protokolle, protokollin A dhe protokollin B dhe në vijim me shtojcën 1 dhe shtojcën 2.

Neni 2

Hyrja në fuqi

1. Ky vendim do të hyjë në fuqi ditën e miratimit të tij.

2. Datat e zbatimit të këtij vendimi nuk do të jetë më herët se 26 nëntor 2016 dhe do të njoftohet me shkrim kryetari i Nënkomitetit për doganat dhe rregullat e origjinës nga secila palë e CEFTA-s.

Miratuar në Çisinau, më 26 nëntor 2015, në prani të përfaqësuesve të të gjitha palëve të CEFTA-s.

ANEKS

PROTOKOLLI A NË LIDHJE ME PËRKUFIZIMIN E KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE TË ORIGJINËS” DHE METODAVE TË BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

Neni 1

Rregullat e zbatueshme të origjinës

a) Me qëllim zbatimin e nenit 14 të aneksit 1 (CEFTA 2006) në Marrëveshjen e Amendimit dhe Zgjerimit të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, të lidhur në Bukuresht, më 19 dhjetor 2006 (Marrëveshja), do të zbatohen shtojca I dhe dispozitat përkatëse të shtojcës II të

Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale Pan-euro-mesdhetare të Origjinës², më poshtë e referuar si “Konventa”.

Të gjitha referencat e “marrëveshjes përkatëse” në shtojcën I dhe në dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale Pan-euro-mesdhetare të Origjinës do të interpretohen siç parashtrihen në Marrëveshje.

Neni 2

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kur lindin mosmarrëveshje në lidhje me verifikimin e procedurave të nenit 32 të shtojcës I të Konventës, të cilat nuk mund të zgjidhen ndërmjet autoriteteve doganore që kërkojnë verifikim dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, atëherë U parashtrihen Komisionit të Përbashkët sipas neneve 42 dhe 43 të CEFTA 2006.

2. Në të gjitha rastet, zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes importuesit dhe autoriteteve doganore të Palës CEFTA importues do të kryhet sipas legjislacionit të atij Palës CEFTA.

Neni 3

Amendimet e protokollit

Komisioni i Përbashkët i parashikuar në nenin 14, paragrafi 1, të CEFTA 2006, mund të vendosë të amendojë dispozitat e këtij protokollit.

Neni 4

Tërheqja nga Konventa

1. Nëse një nga palët e CEFTA-s informon me shkrim depozituesit e Konventës për synimet për t'u tërhequr nga Konventa, sipas nenit 9 të saj, palët e tjera të CEFTA-s duhet të hyjnë menjëherë në bisedime mbi rregullat e origjinës, me qëllim zbatimin e Marrëveshjes.

2. Deri në hyrjen në fuqi të këtyre rregullave të reja të negociuara të origjinës, rregullat e origjinës të përfshira në shtojcën I dhe, kur është e përshtatshme, edhe dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës, të zbatueshme në momentin e tërheqjes, do të vazhdojnë të zbatohen për këtë Marrëveshje. Megjithatë, që nga momenti i tërheqjes, rregullat e origjinës të përfshira në

² GZ L 54, 26.2.2013, f. 4



shtojcën I dhe, kur gjejnë zbatim, edhe dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës do të interpretohen në mënyrë që të lejojnë akumulimin dypalësh vetëm ndërmjet palës së tërhequr dhe palëve të tjera të CEFTA-s.

Neni 5

Dispozita kalimtare – akumulimi

1. Pavarësisht nenit 3 të shtojcës I të Konventës, rregullat e akumulimit të parashikuara në nenet e mëparshme 3 dhe 4, të aneksit 4, protokollin mbi përkufizimin e konceptit të “produkteve të origjinës” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, siç janë amenduar me vendimin nr. 3/2013 do të vazhdojnë të zbatohen ndërmjet palës CEFTA ku Konventa nuk bëhet e zbatueshme dhe palët e tjera të CEFTA-s derisa Konventa të bëhet e zbatueshme në lidhje me palën përkatëse të CEFTA-s.

2. Pavarësisht neneve 16(5) dhe 21(3) të shtojcës I të Konventës, ku akumulimi përfshin vetëm shtetet EFTA, ishujt Faroe, BE-në, Turqinë dhe palët e CEFTA-s, prova e origjinës mund të jetë një certifikatë lëvizjeje EUR.1 ose një deklaratë origjinë.

3. Format i certifikatës së lëvizjes së mallrave EUR.1 ose i deklaratës së origjinës përcaktuar në aneksin 4 të Marrëveshjes së CEFTA-s nuk duhet të përdoret pas datës 1 qershor të vitit 2016.

PROTOKOLLI B NË LIDHJE ME ZBATIMIN E AKUMULIMIT TË PLOTË DHE RIKTHIMI I PAGESËS SË DOGANËS NË CEFTA DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

Neni 1

Përfshirja e kumulimit të origjinës

Produktet që e kanë fituar origjinën e tyre nga zbatimi i dispozitave të parashikuara në këtë protokoll do të përfshihen nga kumulimi, siç përmendet në nenin 3 të shtojcës I të Konventës.

Neni 2

Kumulimi i origjinës

1. Me qëllim zbatimin e nenit 2(1) të shtojcës I të Konventës, punimi dhe përpunimi i kryer nga një palë e CEFTA-s do të konsiderohet sikur është kryer nga secila palë tjetër e CEFTA-s kur produktet e marra u nënshtrohen punimeve apo

përpunimeve vijuese në palën në fjalë. Kur, bazuar në këtë dispozitë, produktet e origjinës janë marrë në dy apo më shumë palë të përfshira, ato do të konsiderohen si me origjinë nga CEFTA vetëm nëse punimi dhe përpunimi tejkalon operacionet e referuara në nenin 6 të shtojcës I të Konventës.

2. Me qëllim zbatimin e nenit 2 (1)(b) të shtojcës I të Konventës, punimi dhe përpunimi i kryer në Bashkimin Evropian, ishujt Faroe, Islandë, Norvegji, Zvicër (përfshirë Lihtenshtejnin) dhe Turqia, do të konsiderohen të kryera jashtë palëve të CEFTA-s kur produktet e përfuara kalojnë në punime dhe përpunime vijuese në një nga palët e CEFTA-s. Kur, bazuar në këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende, ato do të konsiderohen si me origjinë nga CEFTA vetëm nëse punimi ose përpunimi tejkalon operacionet e referuara në nenin 6 të shtojcës I të Konventës.

3. Për qëllimin e zbatimit të nenit 2(1)(b) të shtojcës I të Konventës, punimi dhe përpunimi i kryer në Palët e CEFTA-s do të konsiderohen si të kryer në Bashkimin Evropian, ishujt Faroe, Islandë, Norvegji, Zvicra (duke përfshirë Lihtenshtajni) dhe Turqia, kur produktet e përfuara pësojnë punime apo procese të mëtejshëm në Bashkimin Evropian, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (duke përfshirë Lihtenshtajni) dhe Turqia. Kur, bazuar në këtë dispozitë, produktet me origjinë të fituara në dy ose më shumë palëve të interesuara, do të konsiderohen si origjinuese në Bashkimin Evropian, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (duke përfshirë Lihtenshtajni), dhe Turqia vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon përtej operacioneve të referuara në nenin 6 të shtojcës 1 të Konventës.

4. Akumulimi i dhënë në nenin 2(2) dhe 2(3) mund të jetë i zbatueshëm vetëm në rastin, kur:

a) një marrëveshje tregtare preferenciale, në përputhje me nenin XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT) është e zbatueshme ndërmjet BE-së, ishujve Faroe, Islandës, Norvegjisë, Zvicrës (përfshirë Lihtenshtejnin) dhe Turqisë dhe një pale të CEFTA-s të përfshirë në marrjen e statusit të origjinës dhe të palës së CEFTA-s të destinacionit;

b) materialet dhe produktet e kanë marrë statusin e origjinës nga zbatimi i rregullave të origjinës, identike me ato të dhëna në këtë protokoll;



dhe

c) njoftimi që tregon tërheqjen nga Konventa i është bërë Komisionit të Përbashkët të Konventës në përputhje me shtojcën II të Konventës.

Neni 3

Vërtetimi i origjinës

1. Pa cenuar nenet 16(4) dhe (5) të shtojcës I të Konventës, një certifikatë lëvizjeje EUR.1 do të lëshohet nga autoritet e doganës të një pale të CEFTA-s nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga palët e CEFTA-s, BE-së, ishujve Faroe, Islandës, Norvegjisë, Zvicrës (përfshirë Lihtenshtejnin) dhe Turqinë, në zbatim të akumulimit të referuar në nenin 2 të këtij protokollit dhe përmbush kërkesat e tjera të shtojcës I të Konventës.

2. Pa cenuar nenin 21(2) dhe (3) të shtojcës I të Konventës, një deklaratë origjine mund të bëhet nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Palën CEFTA, BE, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (duke përfshirë Lihtenshtajni) ose Turqia, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenin 2 të këtij aneksi, dhe që plotësojnë kërkesat e tjera të shtojcës I të Konventës.

Neni 4

Deklaratat e furnizuesit

1. Kur një certifikatë lëvizjeje EUR.1 është lëshuar ose një deklaratë e origjinës është bërë në një nga palët CEFTA, BE-ja, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqia për produktet e origjinës, në prodhimin e të cilave, mallra që vijnë nga palë të tjera CEFTA, BE-ja, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqia, të cilat i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në këto palë dhe janë përdorur në vendet e lartpërmendura pa marrë statusin preferencial të origjinës, duhet pasur parasysh deklaratat e furnizuesit e dhënë për këto mallra në përputhje me këtë nen.

2. Deklarata e furnizuesit e referuar në paragrafin 1 të këtij neni shërben si provë e punimit apo përpunimit të kryer në palët CEFTA, BE, ishujt Faroe, Islandë, Norvegji, Zvicër (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqi për mallrat në fjalë, me qëllim përcaktimin nëse produktet, në prodhimin e të cilave janë përdorur këto mallra, mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga palët

CEFTA, BE-ja, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqia, ose përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të Konventës.

3. Një deklaratë e veçantë e furnizuesit, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 4 të këtij neni, duhet lëshuar nga furnizuesi për çdo dërgesë mallrash në formën e përshkruar në aneksin 1 të këtij protokollit në një letër të bashkëlidhur faturës, me dokumentin e furnizimit ose me çdo dokument tjetër tregtar që përshkruan mallrat në fjalë me hollësi të mjaftueshme për identifikimin e tyre.

Kur një furnizues furnizon rregullisht një klient të caktuar me mallra për të cilat punimi ose përpunimi i kryer në palët CEFTA, BE, ishujt Faroe, Islandë, Norvegji, Zvicër (duke përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqi pritet të mbetet konstant për një periudhë të konsiderueshme kohe, ai mund të japë një deklaratë të vetme furnizuesi për të mbuluar dërgesat vijuese të këtyre mallrave (të referuar si “deklarata afatgjatë e furnizuesit”).

Deklarata afatgjatë e furnizuesit normalisht mund të jetë e vlefshme për një periudhë deri në një vit nga data e paraqitjes së kësaj deklarate. Autoritetet doganore të një pale të CEFTA-s ku është bërë deklarata, vendosin kushtet nën të cilat mund të përdoren periudha më të gjata.

Deklarata afatgjatë e furnizuesit duhet të bëhet nga furnizuesi në formën e përshkruar në aneksin 2 të këtij protokollit dhe duhet të përshkruajë mallrat me hollësi të mjaftueshme për të lejuar identifikimin e tyre. Ajo duhet të paraqitet në doganën përkatëse para se të arrijë dërgesa e parë e mallrave të mbuluara nga kjo deklaratë ose së bashku me dërgesën e parë.

Furnizuesi duhet të informojë doganën menjëherë nëse deklarata afatgjatë e furnizuesit nuk është më e zbatueshme për mallrat e furnizuara prej tij.

4. Deklarata e furnizuesit së cilës i referohen paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni duhet të shtypet ose printohet në anglisht, në përputhje me dispozitat e ligjit kombëtar të palës së përfshirë ku është bërë deklarata dhe duhet të mbajë nënshkrimin origjinal të furnizuesit në letër. Deklarata mund të jetë dorëshkrim; në këtë rast duhet të shkruhet me bojë, me shkronja shtypi.

5. Furnizuesi që bën deklaratën duhet të jetë i përgatitur ta lëshojë në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të palës ku bëhet deklarata, si



dhe të japë të gjitha dokumentet e duhura që provojnë se informacioni i dhënë në deklaratë është i saktë.

Neni 5

Dokumentet mbështetëse

Deklaratat e furnizuesit që provojnë se punimi dhe përpunimi i kryer në palët CEFTA, në BE, ishujt Faroe, Islandë, Norvegji, Zvicër (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqi me materialet e përdorura, të bëra në një nga këto vende, duhen trajtuar si dokumente të referuara në nenet 16(3) dhe 21(5) të shtojcës I të Konventës dhe nenin 4 të këtij protokollit, të përdorura me qëllim vërtetimin se produktet e mbuluara nga certifikata e lëvizjes EUR.1 ose të një deklaratë origjinë mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga palët CEFTA, BE-ja, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqia dhe i përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të Konventës.

Neni 6

Ruajtja e deklaratave të furnizuesit

1. Furnizuesi që bën një deklaratë furnizimi duket të mbajë për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe të gjitha faturave, dokumenteve të dërgesave apo dokumente të tjera tregtare si anekse të kësaj deklarate, si dhe dokumentet e referuara në nenin 3(5) të këtij protokollit.

2. Furnizuesi që bën një deklaratë afatgjatë furnizuesi duhet të mbajë për të paktën tre vjet kopjet e deklaratës dhe të të gjitha faturave, dokumenteve të dërgesave apo dokumente të tjera tregtare në lidhje me mallrat e mbuluara nga deklaratat dërguar klientit përkatës, si dhe dokumentacionin e referuar në nenin 5 të këtij protokollit. Kjo periudhë fillon nga data e skadimit të vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnizuesit.

Neni 7

Bashkëpunimi administrativ

Pa cenuar nenet 31 dhe 32 të shtojcës I të Konventës, për të garantuar zbatimin e saktë të këtij aneksi, palët e CEFTA-s BE-ja, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqia duhet të asistojnë njëra-tjetrën nëpërmjet autoriteteve kompetente doganore, në kontrollin e autenticitetit të certifikatave të lëvizjes EUR.1 të origjinës së deklaratave ose të deklaratave

të furnizuesit dhe saktësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 8

Verifikimi i deklaratave të furnizuesit

1. Verifikimet e mëposhtme të deklaratave të furnizuesit ose të deklaratave afatgjata të furnizuesit mund të kryhen rastësisht ose sa herë që autoritetet doganore të palës ku janë paraqitur këto deklarata për të përdorur një certifikatë të lëvizjes EUR.1 ose për të bërë një deklaratë të origjinës kanë dyshime të arsyeshme për autenticitetin e dokumentit ose korrektesinë e informacionit të dhënë në dokument.

2. Me qëllim zbatimin e dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, autoritetet doganore të palës, të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të kthejnë deklaratën e furnizuesit ose deklaratën afatgjatë të furnizuesit dhe faturat, dokumentet e furnizimit dhe dokumentet e tjera tregtare në lidhje me mallrat e mbuluara nga kjo deklaratë tek autoritetet doganore të palës ku është bërë deklarata duke dhënë, atëherë kur është e nevojshme, arsyet për lëndën apo formën e kërkesës për verifikim.

Ato duhet të paraqesin, në bazë të kërkesës për verifikime të mëtejshme, çdo dokument dhe informacion që kanë marrë, duke sugjeruar se informacioni i dhënë në deklaratën e furnizuesit ose në deklaratën afatgjatë të furnizuesit, nuk është i saktë.

3. Verifikimi duhet të kryhet nga autoritetet doganore të palës ku është bërë deklarata e furnizuesit ose deklarata afatgjatë e furnizuesit. Për këtë qëllim, ata kanë të drejtë të kërkojnë çdo lloj prove dhe të kryejnë çdo lloj inspektimi në llogari të furnizuesit apo kontrole të tjera që i çmojnë të nevojshme.

4. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin duhet të informohen për rezultatet sa më shpejt të jetë e mundur. Këto rezultate duhet të tregojnë qartë nëse informacioni i dhënë në deklaratën e furnizuesit apo në deklaratën afatgjatë të furnizuesit, është i saktë dhe t'ua bëjë të mundur të përcaktojnë nëse dhe deri në cilën masë duhet marrë në konsideratë kjo deklaratë për të lëshuar certifikatën e lëvizjes EUR.1 ose për të bërë një deklaratë të origjinës.



Neni 9
Sanksione

Çdo personi që harton apo urdhëron hartimin e një dokumenti i cili përmban informacion të pasaktë, me qëllim përfundimin e një trajtimi preferencial për produktet, i nënshtrohet sanksioneve.

Neni 10

Ndalimi i rikthimit të pagesës së doganës ose i çlirimit nga detyrimet doganore

1. Ndalesa në paragrafin 1, të nenit 14, të shtojcës I, të Konventës nuk gjen zbatim në tregtinë dypalëshe ndërmjet palëve të CEFTA-s, BE-ja, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqia.

2. Palët e CEFTA-s, BE-ja, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqia mund të lidhin marrëveshje për rikthimin e pagesave doganore apo përjashtimin nga detyrimet doganore ose për pagesat e tyre, duke pasur efekte të barasvlershme, të cilat zbatohen për materialet jo të origjinës që përdoren në prodhimin e produkteve origjinale, me kusht që:

a) një marrëveshje tregtie preferenciale në përputhje me nenin XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATI) të jetë e zbatueshme ndërmjet BE-së, ishujve Faroe, Islandës, Norvegjisë, Zvicrës (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqisë dhe një pale të CEFTA-s të përfshirë në marrjen e statusit të origjinës dhe palës së CEFTA-s të destinacionit;

b) materialet dhe produktet të kenë marrë statusin e origjinës nga zbatimi i rregullave të origjinës identike me ato të dhëna në këtë protokoll;

c) dhe

d) njoftimi që tregon tërheqjen nga Konventa të jetë kryer pranë Komisionit të Përbashkët të Konventës në përputhje me shtojcën II të Konventës.

ANEKSI 1

DEKLARATA E FURNIZUESIT

Deklarata e furnizuesit, teksti i së cilës është dhënë më poshtë, duhet të plotësohet në përputhje me shënimet sqaruese. Megjithatë, këto shënime sqaruese nuk duhen riprodhuar.

DEKLARATA E FURNIZUESIT

Për mallrat që i janë nënshtuar punimit ose përpunimit në palët e CEFTA-s, BE-në, ishujt Faroe, Islandë, Norvegji, Zvicër (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqi pa marrë statusin preferencial të origjinës.

Unë, i nënshkruari, furnizuesi i mallrave të përshkruara në dokumentin e bashkëlidhur, deklaroj se:

1. Materialet e mëposhtme, të cilat nuk janë me origjinë nga vendet e CEFTA-s, BE-ja, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqia janë përdorur në palët e CEFTA-s për të prodhuar këto mallra:

Përshkrimi i mallrave të furnizuara ⁽¹⁾	Përshkrimi i materialeve jo të origjinës të përdorura	Emërtesa e materialeve jo të origjinës të përdorura ⁽²⁾	Vlera e materialeve jo të origjinës të përdorura ⁽²⁾⁽³⁾
Vlera totale			
Vlera totale			

2. Të gjitha materialet e tjera të përdorura në palët e CEFTA-s për të prodhuar këto mallra janë me origjinë nga palët e CEFTA-s, BE-ja, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqia.

3. Mallrat e mëposhtme i janë nënshtuar punimit ose përpunimit jashtë palëve të CEFTA-s, BE-së, ishujve Faroe, Islandës, Norvegjisë, Zvicrës (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqisë, në përputhje me nenin 11 të Konventës dhe kanë marrë vlerën e shtuar totale, si më poshtë:



Përshkrimi i mallrave të furnizuara	Vlera e shtuar totale e marrë jashtë palëve të CEFTA-s, BE-së, ishujve Faroe, Islandës, Norvegjisë, Zvicrës (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqisë ⁽⁴⁾
	(Vendi dhe data)
	(Adresa dhe nënshkrimi i furnizuesit, përveç kësaj emri i personit që nënshkruan deklaratën duhet të jetë i dukshëm me shkronja të qarta)

⁽¹⁾ Kur fatura, dokumenti i dërgesës apo dokumente të tjera tregtare bashkëngjitur me deklaratën kanë lidhje me lloje të ndryshme mallrash ose kur mallrat nuk përmbajnë materiale jo të origjinës në masë të njëjtë, furnizuesi duhet t'i diferencojë qartë ato.

Shembull:

Dokumenti ka lidhje me modele të ndryshme motorësh elektrikë të modelit 8501 që përdoren në prodhimin e makinave të larjes së rrobave me emërtesën 8450. Natyra dhe vlera e materialeve jo të origjinës të përdorur në prodhimin e këtyre motorëve ndryshon nga një model tek tjetri. Si rrjedhojë, modelet duhen diferencuar në kolonën e parë dhe treguesit në kolonat e tjera duhet të jepen veçmas për secilin nga modelet për të bërë të mundur për prodhuesin e makinave larëse të kryejë një vlerësim të saktë të statusit të origjinës të produkteve të tij në varësi të modeleve të motorëve elektrikë që përdor ai.

⁽²⁾ Treguesit e kërkuar në këto kolona duhen dhënë vetëm kur janë të nevojshëm.

Shembuj:

Rregulli për veshjet e ish- Kapitullit 62 parashikon që mund të përdoren fije jo të origjinës. Nëse prodhuesi i veshjeve të tilla në Serbi përdor pëlhuara të importuara nga Maqedonia, të cilat janë prodhuar nga endja e fijeve jo të origjinës, furnizuesit maqedonas i mjafton të përshkruajë në deklaratën e tij materialet jo të origjinës të përdorura si fije, pa qenë nevoja të tregojë emërtesën dhe vlerën për secilin lloj fijeje.

Një prodhues hekurit me emërtesën 7217 që e ka prodhuar atë nga shufra hekurit jo të origjinës duhet të specifikojë në kolonën e dytë "shufra hekurit". Nëse ky tel do të përdoret për prodhimin e një makinerie për të cilën rregulli përmban një kufizim për materialet jo të origjinës të përdorura në një përqindje të caktuar, është e nevojshme të tregohet në kolonën e tretë vlera e shufrave jo të origjinës.

⁽³⁾ "Vlera e materialeve" do të thotë vlera e doganës në kohën e importit të materialeve jo të origjinës të përdorura ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të vërtetohet, çmimi i parë i vërtetueshëm i paguar për materialet në një nga palët e CEFTA-s.

Vlera e saktë për çdo material jo të origjinës të përdorur duhet dhënë për njësi për mallrat e specifikuar në kolonën e parë.

⁽⁴⁾ "Vlera e shtuar totale" do të thotë të gjitha kostot e akumuluaras jashtë palëve të CEFTA-s, BE-së, ishujve Faroe, Islandës, Norvegjisë, Zvicrës (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqisë, duke përfshirë vlerën e të gjitha materialeve të shtuara aty. Vlera e shtuar totale e saktë e përftuar jashtë palëve të CEFTA-s, BE-së, ishujve Faroe, Islandës, Norvegjisë, Zvicrës (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqisë, duhet dhënë për njësi për mallrat e specifikuar në kolonën e parë.

ANEKSI 2

DEKLARATA AFATGJATË E FURNIZUESIT

Deklarata e furnizuesit, teksti i së cilës është dhënë më poshtë, duhet plotësuar në përputhje me shënimet sqaruese. Megjithatë, këto shënime sqaruese nuk duhen riprodhuar.

DEKLARATA AFATGJATË E FURNIZUESIT

Për mallrat që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në palët e CEFTA-s, BE, ishujt Faroe, Islandë, Norvegji, Zvicër (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqi pa marrë statusin preferencial të origjinës.

Unë, i nënshkruari, furnizuesi i mallrave të përshkruara në këtë dokument, të cilat i dërgohen rregullisht⁽¹⁾, deklaroj se:

1. Materialet e mëposhtme, të cilat nuk janë me origjinë nga vendet CEFTA-s, BE-ja, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqia janë përdorur në palët e CEFTA-s për të prodhuar këto mallra:



Përshkrimi i mallrave të furnizuara ⁽²⁾	Përshkrimi i materialeve jo të origjinës të përdorura	Emërtesa e materialeve jo të origjinës të përdorura ⁽³⁾	Vlera e materialeve jo të origjinës të përdorura ⁽³⁾⁽⁴⁾
Vlera totale			
Vlera totale			

2. Të gjitha materialet e tjera të përdorura në palët e CEFTA-s për të prodhuar këto mallra janë me origjinë nga palët e CEFTA-s, BE-ja, ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqia.

3. Mallrat e mëposhtme i janë nënshtruar punimit ose përpunimit jashtë palëve të CEFTA-s, BE-së, ishujve Faroe, Islandës, Norvegjisë, Zvicrës (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqisë, në përputhje me nenin 11 të Konventës dhe kanë marrë vlerën e shtuar totale si më poshtë:

Përshkrimi i mallrave të furnizuara	Vlera e shtuar totale e marrë jashtë palëve të CEFTA-s, BE-së, ishujve Faroe, Islandës, Norvegjisë, Zvicrës (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqisë ⁽⁵⁾
	(Vendi dhe data)
	(Adresa dhe nënshkrimi i furnizuesit, përveç kësaj emri i personit që nënshkruan deklaratën duhet të jetë i dukshëm me shkronja të qarta)

Kjo deklaratë është e vlefshme për të gjitha dërgesat vijuese të këtyre mallrave të nisura nga

në.....⁽⁶⁾

Unë marr përsipër të informoj⁽¹⁾ menjëherë nëse kjo deklaratë nuk është më tej e vlefshme.

.....

(Vendi dhe data)

.....

.....

.....

.....

..... (Adresa dhe nënshkrimi i furnizuesit, përveç kësaj emri i personit që nënshkruan deklaratën duhet të jetë i dukshëm me shkronja të qarta)

⁽¹⁾ Emri dhe adresa e klientit.

⁽²⁾ Kur fatura, dokumenti i dërgesës apo dokumente të tjera tregtare bashkëngjitur me deklaratën kanë lidhje me lloje të ndryshme mallrash, ose kur mallrat nuk përmbajnë materiale jo të origjinës në masë të njëjtë, furnizuesi duhet t'i diferencojë qartë ato.

Shembull:

Dokumenti ka lidhje me modele të ndryshme motorësh elektrikë të modelit 8501 që përdoren në prodhimin e makinave të larjes së rrobave me emërtesën 8450. Natyra dhe vlera e materialeve jo të origjinës të përdorur në prodhimin e këtyre motorëve ndryshon nga një model tek tjetri. Si rrjedhojë, modelet duhen diferencuar në kolonën e parë dhe treguesit në kolonat e tjera duhet të jepen veçmas për secilin nga modelet për të bërë të mundur për prodhuesin e makinave larëse të kryejë një vlerësim të saktë të statusit të origjinës të produkteve të tij në varësi të modeleve të motorëve elektrikë që përdor.

⁽³⁾ Treguesit e kërkuar në këto kolona duhen dhënë vetëm kur janë të nevojshëm.



Shembuj:

Rregulli për veshjet e ish-kapitulit 62 parashikon që mund të përdoren fije jo të origjinës. Nëse prodhuesi i veshjeve të tilla në Serbi përdor pëllhura të importuara nga Maqedonia, të cilat janë prodhuar nga endja e fijeve jo të origjinës, furnizuesit maqedonas i mjafton të përshkruajë në deklaratën e tij materialet jo të origjinës të përdorura si fije, pa qenë nevoja të tregojë emërtesën dhe vlerën për secilën lloj fijeje.

Një prodhues hekuri me emërtesën 7217 që e ka prodhuar atë nga shufra hekuri jo të origjinës duhet të specifikojë në kolonën e dytë “shufra hekuri”. Nëse ky tel do të përdoret për prodhimin e një makinerie për të cilën rregulli përmban një kufizim për materialet jo të origjinës të përdorura në një përqindje të caktuar, është e nevojshme të tregohet në kolonën e tretë vlera e shufrave jo të origjinës.

⁽⁴⁾ “Vlera e materialeve” do të thotë vlera e doganës në kohën e importit të materialeve jo të origjinës të përdorura ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të vërtetohet, çmimi i parë i vërtetueshëm i paguar për materialet në një nga palët e CEFTA-s.

Vlera e saktë për çdo material jo të origjinës të përdorur duhet dhënë për njësi për mallrat e specifikuar në kolonën e parë.

⁽⁵⁾ “Vlera e shtuar totale” do të thotë të gjitha kostot e akumuluar jashtë palëve të CEFTA-s, BE-së, ishujve Faroe, Islandës, Norvegjisë, Zvicrës (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqisë, duke përfshirë vlerën e të gjitha materialeve të shtuara aty.

Vlera e shtuar totale e saktë e përfutur jashtë palëve të CEFTA-s, BE-së, ishujve Faroe, Islandës, Norvegjisë, Zvicrës (përfshirë Lihtenshtejnin) ose Turqisë duhet dhënë për njësi për mallrat e specifikuar në kolonën e parë.

⁽⁶⁾ Përfshini datat. Periudha e vlefshmërisë për deklaratën afatgjatë të furnizuesit normalisht nuk duhet të kalojë 12 muaj dhe i nënshtrohet kushteve të vendosura nga autoritetet doganore të vendit ku është bërë deklarata afatgjatë e furnizuesit.

LIGJ Nr. 60/2016

PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni nga sinjalizuesit në sektorin publik e privat, mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e autoriteteve publike e të subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

a) parandalimi dhe goditja e korrupsionit në sektorin publik e privat;

b) mbrojtja e individëve që sinjalizojnë veprimet ose praktikave të dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës;

c) nxitja e sinjalizimit të veprimeve ose praktikave të dyshuara të korrupsionit.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet publik” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit.

2. “Hakmarrje” është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim, i kryer nga organizata, me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.

3. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas këtij ligji, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

4. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

5. “Informacion publik” ka të njëjtin kuptim të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit.

6. “Korrupsion” është çdo veprim ose mosveprim i kundërligjshëm, sipas legjislacionit penal në fuqi, në lidhje me çdo formë të korrupsionit aktiv, korrupsionit pasiv, shpërdorimit të detyrës ose kompetencave, ushtrimit të ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave ose marrjen e vendimeve, shpërdorimit të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, përfitimit të paligjshëm të interesave, si dhe çdo akt tjetër i ngjashëm me to.

7. “Mbrojtje” është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të këtij ligji.

8. “Njësia përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit



të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

9. “Organizatë” është autoriteti publik ose subjekti privat.

10. “Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit të njësisë përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik apo subjektin privat.

11. “Sinjalizim i brendshëm” është raportimi i kryer nga sinjalizuesi brenda njësisë përgjegjëse të organizatës, sipas nenit 10 të këtij ligji.

12. “Sinjalizim i jashtëm” është raportimi i kryer nga sinjalizuesi pranë ILDKPKI-së, sipas nenit 11 të këtij ligji.

13. “Sinjalizues” është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

14. “Subjekt privat” është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

15. “Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

Neni 4

Parimet e sinjalizimit

Mbrojtja e sinjalizuesve të veprimeve ose praktikave të dyshuara të korrupsionit, sipas këtij ligji, bazohet në parimet e:

a) ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror nga njësisë përgjegjëse dhe ILDKPKI-ja;

b) njohjes së identitetit të sinjalizuesit, përveç rastit kur ky ligj lejon pranimin e një sinjalizimi anonim;

c) sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupsionit;

ç) integritetit dhe paanshmërisë së njësisë përgjegjëse dhe ILDKPKI-së gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;

d) zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;

dh) procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

KREU II SINJALIZIMI

Neni 5 **Sinjalizimi**

Çdo person, i cili vihet në dijeni për veprime ose praktika të dyshuara të korrupsionit, gjatë punës ose në lidhje me veprimtarinë e tij të punës pranë organizatës, ka të drejtë të sinjalizojë këtë fakt te njësisë përgjegjëse brenda organizatës ose ILDKPKI-së, sipas rastit.

Neni 6

Mirëbesimi i sinjalizuesit

1. Sinjalizuesit i ofrohet mbrojtja për sinjalizimin e kryer në kushtet e mirëbesimit, të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni, sipas kritereve të parashikuara në këtë ligj.

2. Sinjalizuesi konsiderohet se ka vepruar në mirëbesim, nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se është duke sinjalizuar një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, si dhe:

a) nuk e dinte ose nuk kishte mundësi objektive për të ditur se informacioni i sinjalizuar nuk ishte i vërtetë ose i saktë edhe nëse më vonë rezulton se ka gabuar në lidhje me vërtetësinë ose saktësinë e tij, ose vërtetohet nga organet kompetente se nuk është kryer një veprë penale e korrupsionit;

b) sinjalizimi nuk kryhet në mënyrë abuzive, shpifëse ose sinjalizuesi nuk mashtron mbi informacionin e sinjalizuar.

3. Sinjalizuesi prezumohet të jetë në mirëbesim, derisa nuk provohet e kundërta nga njësisë përgjegjëse ose ILDKPKI-ja, sipas rastit.

Neni 7

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para ILDKPKI-së ose njësisë përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim prej tyre. Sinjalizimi përmban të paktën:

a) të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;



b) të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;

c) përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;

ç) referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;

d) në rastin e sinjalizimit të jashtëm, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.

2. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet, nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.

3. Pavarësisht nga ekzistenca e njësisë përgjegjëse pranë organizatës, sinjalizuesi mund të nisë një procedurë të jashtme sinjalizimi pranë ILDKPKI-së, sipas nenit 11 të këtij ligji.

Neni 8

Sinjalizimi në publik

Në rast se sinjalizuesi njofton publikisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, gëzon të drejtën e mbrojtjes, sipas këtij ligji, deri në çastin kur sinjalizimi bëhet publik.

Neni 9

Bashkëpunimi

Në zbatim të parimit të ruajtjes së konfidencialitetit, sekretit shtetëror dhe mbrojtjes së të dhënave personale, njësitë përgjegjëse bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me ILDKPKI-në për shkëmbim të dhënash, të plota dhe pa asnjë rezervë, me qëllim shqyrtimin dhe zgjidhjen e një rasti të sinjalizuar kur, pavarësisht nga organizata e sinjalizuesit, të sinjalizuarit i përkasin organizatave të ndryshme.

KREU III

STRUKTURAT E SHQYRTIMIT TË SINJALIZIMIT

Neni 10

Sinjalizimi i brendshëm dhe njësitë përgjegjëse

1. Pranë çdo autoriteti publik, i cili ka më shumë se 80 të punësuar, dhe subjekti privat, i cili ka më shumë se 100 të punësuar, caktohet një njësi përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet, sipas këtij ligji.

2. Njësia përgjegjëse mund të përbëhet nga një ose më shumë persona, sipas përbërjes dhe strukturës së organizatës, të trajnuar posaçërisht në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve.

3. ILDKPKI-ja përcakton me udhëzim strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimin e punonjësve të njësisë përgjegjëse të subjekteve private. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim marrëdhëniet e punës, strukturën dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike.

Neni 11

Sinjalizimi i jashtëm tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

1. ILDKPKI-ja heton drejtpërdrejt sinjalizimin për veprimet ose praktikën e dyshuara të korrupsionit në organizata, të cilat nuk kanë një njësi përgjegjëse për këtë qëllim.

2. Pavarësisht nga njësia përgjegjëse brenda organizatës, sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë veprën e dyshuar të korrupsionit tek ILDKPKI-ja në rastet kur:

a) njësia përgjegjëse nuk fillon hetimin administrativ ose përfundon hetimin në kundërshtim me nenin 14 të këtij ligji;

b) ekziston dyshimi i arsyeshëm se pritësi i sinjalizimit në njësinë përgjegjëse ose persona të lidhur me të janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, pasuror ose personal, në veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Sipas rastit, person i lidhur ka të njëjtën kuptim me përcaktimet e bëra në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ose ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;



c) ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e njësisë përgjegjëse në shqyrtimin e sinjalizimit, sipas parimeve të këtij ligji;

ç) prova e sinjalizuesit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, mund të fshihet ose të shkatërrohet nga organizata.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, çdo hetim i njësisë përgjegjëse, nëse ka filluar, ndërpritet dhe sinjalizimi hetohet në vijim nga ILDKPKI-ja.

KREU IV

PROCEDURA E HETIMIT ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT

Neni 12

Parimet e përgjithshme të hetimit administrativ

1. Në kryerjen e funksioneve të saj, njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja duhet:

a) të veprojë me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitimë të sinjalizuesit;

b) të veprojë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave, sipas këtij ligji;

c) të shmangë çdo konflikt interesi të mundshëm dhe të deklarojë menjëherë tek organizata ose ILDKPKI-ja konfliktin e interesit përpara fillimit të hetimit administrativ të një sinjalizimi;

ç) të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;

d) të ruajë konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojë të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi, në përputhje me nenet 15 dhe 16 të këtij ligji;

dh) të ruajë sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi në zbatim të ligjit.

2. Gjatë procesit të hetimit administrativ, sinjalizuesi ka të drejtë të mos zbulojë burimet e informacionit.

Neni 13

Procedura e hetimit administrativ

1. Sipas rastit, çdo njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë ligj. Për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njësia përgjegjëse pranë autoritetit publik dhe ILDKPKI-së zbatojnë dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

2. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.

3. Gjatë periudhës së hetimit administrativ, njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Për këtë qëllim, njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.

4. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga drejtuesi i hetimit.

5. Çdo pale pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:

a) mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;

b) mund të konsultohet me dosjen e hetimit;

c) ka të drejtë të dëgjohej në lidhje me pretendimet e tij.

6. Organizata ose ILDKPKI-ja duhet të vendosë në dispozicion të hetimit të dhënat, dokumentacionin dhe provat e zotëruara prej saj.

7. Njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë nen, njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.



8. Nëse në përfundim të hetimit administrativ të sinjalizimit nga njësi përgjegjëse e një autoriteti publik ose ILDKPKI-ja rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja, sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent.

9. ILDKPKI-ja dhe organizata, në bashkëpunim me ILDKPKI-në, marrin masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.

10. Çdo organizatë, sipas udhëzimeve të ILDKPKI-së, dhe ILDKPKI-ja, miratojnë rregullore të brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidentalitetit, sipas këtij ligji.

Neni 14

Mosfillimi dhe përfundimi i hetimit administrativ

1. Njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse:

- a) sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 7, i këtij ligji, dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
- b) sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji, sipas nenit 3, pika 6, të këtij ligji;
- c) kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.

2. Njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja ka të drejtë të përfundojë hetimin administrativ nëse:

- a) gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja njofton menjëherë prokurorinë ose Policinë e Shtetit.
- b) sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të këtij ligji.

3. Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për mosfillimin ose përfundimin e hetimit administrativ, i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

Neni 15

Konfidentaliteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm ose të jashtëm, identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.

2. ILDKPKI-ja ose njësi përgjegjëse duhet të ruajnë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar te persona të tretë brenda ose jashtë organizatës ose ILDKPKI-së, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

3. Njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja, në komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi ose me çdo subjekt apo autoritet tjetër, privat ose shtetëror, respekton detyrimin e konfidentalitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshjeje konfidentaliteti mes palëve.

4. Çdo person, i cili merr informacion konfidencial nga njësitë përgjegjëse ose ILDKPKI-ja, për qëllim të këtij ligji, ka të njëjtin detyrim për përpunimin e informacionit në mënyrë konfidenciale.

Neni 16

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të këtij ligji. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton me udhëzim të veçantë kushtet dhe kriteret e përpunimit dhe kohën e mbajtjes së të dhënave personale në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve, sipas këtij ligji.



KREU V
TË DREJTAT DHE MBROJTJA E
SINJALIZUESVE

Neni 17

Të drejtat e sinjalizuesit

1. Të drejtat dhe interesat e sinjalizuesve mbrohen në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme.

2. Sinjalizuesi gëzon të drejtën e:

a) konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit, që përfshin, gjithashtu, mundësinë e sinjalizimit anonim të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni, sipas nenit 7, pika 2, të këtij ligji;

b) ruajtjen e konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuesit;

c) mbrojtjes kundër hakmarrjes.

3. Të drejtat e sinjalizuesit garantohen, sipas këtij ligji:

a) gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit;

b) pas përfundimit të procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, me qëllim kryerjen normale të detyrave funksionale të sinjalizuesit në organizatën e tij;

c) pas përfundimit të marrëdhënies së punës së sinjalizuesit me organizatën e tij, kur, nga rrethana të bazuara dhe të arsyeshme, sinjalizuesi ka kërkuar mbrojtjen nga ILDKPKI-ja.

4. Çdo rregull ose marrëveshje private, në bazë të së cilës përjashtohen ose kufizohen të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesit, sipas këtij ligji, është e pavlefshme. Të drejtat e sinjalizuesit kanë epërsi ndaj marrëveshjeve të konfidencialitetit.

5. Sinjalizuesi informohet nga organizata dhe ILDKPKI-ja, në mënyrë të plotë dhe në gjuhë të kuptueshme, për të drejtat dhe mbrojtjen e ofruar nga organizata e tij dhe ILDKPKI-ja, sipas këtij ligji.

Neni 18

Mbrojtja kundër hakmarrjes

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, mbrohet ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë ndaj tij nga organizata, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

a) shkarkimin nga puna;

b) pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;

- c) transferimin brenda ose jashtë organizatës;
- ç) uljen në detyrë;
- d) uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
- dh) humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
- e) mosngritjen në detyrë;
- ë) heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- f) vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
- g) forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.

2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.

3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të organizatës, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, organizata merr masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë. Në rast të kundërt, ILDKPKI-ja, me kërkesë të sinjalizuesit, i drejtohet organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, për të urdhëruar autoritetin publik ose urdhëron subjektin privat të marrë të gjitha masat, sipas këtij neni. Nëse organi kompetent ose subjekti privat nuk merr masat e kërkuara nga ILDKPKI-ja, çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Neni 19

Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje

1. Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, paraqet kërkesë për mbrojtje te njësia përgjegjëse. Njësia përgjegjëse merr menjëherë masat dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës, vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes. Në rast të shkeljes së këtij afati, kërkesa paraqitet tek ILDKPKI-ja, që vendos brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës.

2. ILDKPKI-ja heton pretendimet për hakmarrje për të përcaktuar nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur, është duke ndodhur ose pritet të ndodhë një akt hakmarrjeje.

3. ILDKPKI-ja, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, njofton me shkrim sinjalizuesin për regjistrimin e pretendimit dhe emrin e personit pranë ILDKPKI-së, i cili do të ndjekë çështjen.



4. Organizata, me kërkesë të ILDKPKI-së, duhet të provojë që masat e marra në dëm të sinjalizuesit janë bazuar në shkaqe të ndryshme dhe që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sinjalizimin.

5. ILDKPKI-ja njofton me shkrim sinjalizuesin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për statusin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë. Pavarësisht nga afatet e njoftimit, parashikuar në këtë nen, ILDKPKI-ja është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë për informacion me shkrim, paraqitur në çdo kohë nga sinjalizuesi në lidhje me kërkesën e tij.

6. Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

7. Nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga autoriteti publik, ILDKPKI-ja i drejtohet organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, për të urdhëruar autoritetin publik për marrjen e të gjitha masave për riparimin e shkeljes së kryer. Nëse në përfundim të hetimit rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga subjekti privat, ILDKPKI-ja urdhëron subjektin privat të marrë të gjitha masat për riparimin e shkeljes së kryer. Nëse organi kompetent ose subjekti privat nuk merr masat e kërkuara nga ILDKPKI-ja, sipas kësaj pike, çdo person i interesuar ose ILDKPKI-ja ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

8. ILDKPKI-ja dhe njësitë përgjegjëse, në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga ILDKPKI-ja, miratojnë rregullore për procedurën e shqyrtimit të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja.

Neni 20

Dëmshpërblimi në rastin e hakmarrjes

Sinjalizuesi ka të drejtë të kërkojë në gjykatë shpërblim për dëmin e pësuar nga akti i hakmarrjes, në kuptim të këtij ligji, sipas Kodit Civil.

KREU VI MONITORIMI I MEKANIZMIT TË SINJALIZIMIT

Neni 21

Funksionet e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

Përveç sa parashikohet në këtë ligj, ILDKPKI-ja ka detyrë:

a) të monitorojë dhe të nxjerrë udhëzime për mekanizmat e sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm;

b) të kontrollojë funksionimin e duhur të mekanizmit të sinjalizimit të brendshëm e të njëjësive përgjegjëse të organizatave;

c) të konstatojë kundërvajtjet administrative, sipas këtij ligji, dhe të vendosë gjoba, në përputhje me nenin 23 të këtij ligji;

ç) të marrë dhe të hetojë kërkesat për mbrojtje ndaj masave hakmarrëse kundër sinjalizuesve dhe të garantojë mbrojtjen e sinjalizuesit nga masat hakmarrëse, sipas këtij ligji;

d) mbi bazën e raporteve vjetore të njëjësive përgjegjëse, të hartojë vlerësime dhe të japë rekomandime për zbatimin e këtij ligji;

dh) të ofrojë këshillim dhe mbështetje në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve;

e) të ndërgjegjësojë publikun për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, si dhe të rrisë pranimin kulturor të sinjalizimit.

Neni 22

Raportimi

1. Njësia përgjegjëse zbaton detyrat e ngarkuara nga ILDKPKI-ja për lehtësimin dhe zhvillimin e procesit të sinjalizimit, si dhe i paraqet ILDKPKI-së çdo vit, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raport me shkrim për sinjalizimet e regjistruara, mënyrat e ndjekura për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

2. ILDKPKI-ja publikon çdo vit raport për zbatimin e këtij ligji. Në këtë informacion përfshihen numri i rasteve të sinjalizuara, rezultatet e rasteve, shkalla e ndërgjegjësimit dhe besimit të mekanizmat e sinjalizimit nga publiku, koha e përcaktuar për shqyrtimin e rasteve dhe zbatimin e mekanizmave të mbrojtjes nga hakmarrja.



KREU VII

SHKELJET DHE MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 23

Kundërvajtje dhe masa administrative

1. Shkelja e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë si më poshtë:

a) mosçaktimi i njësisë përgjegjëse nga organizata, në përputhje me pikën 1, të nenit 10, të këtij ligji, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

b) çdo veprim hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit, të marrë nga organizata sipas nenit 18, të këtij ligji, përfshirë refuzimin për të vepruar sipas pikës 3, të nenit 18, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;

c) shkelja e parimeve të hetimit të sinjalizimit nga punonjësi, sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë;

ç) shkelja e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas nenit 15, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 150 000 deri në 300 000 lekë;

d) mosfillimi i hetimit ose përfundimi i hetimit administrativ nga punonjësi, në kundërshtim me nenin 14, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

2. ILDKPKI-ja ka të drejtë të konstatojë kundërvajtjet dhe të vendosë gjobën. Kundër vendimit të ILDKPKI-së mund të bëhet ankim, sipas ligjit për kundërvajtjet administrative.

3. Të ardhurat nga gjobat kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

KREU VIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet ILDKPKI-ja që, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 3, të nenit 10; pikës 10, të nenit 13; pikës 8, të nenit 19; dhe shkronjës “a”, të nenit 21, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 3, të nenit 10, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 3, të nenit 16, të këtij ligji.

4. Ngarkohen subjektet private dhe autoritetet publike, në përputhje me udhëzimet e ILDKPKI-së, që, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojnë rregulloren e parashikuar në nenin 13, pika 10, të këtij ligji.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet juridike prej datës 1 tetor 2016, me përjashtim të detyrimeve të përcaktuara në nenin 10, të këtij ligji, për sinjalizimin e brendshëm për subjektet private, që fillojnë të zbatohen nga data 1 korrik 2017.

Miruar në datën 2.6.2016

Shpallur me dekretin nr. 9647, datë 20.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ**Nr. 61/2016****PËR SHPALLJEN E MORATORIUMIT TË GJUESISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndalimi i ushtrimit të aktivitetit të gjuesisë, me qëllim përmirësimin e gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.

Neni 2

Objekti dhe fusha e veprimit

Ky ligj përcakton rregullat që do të zbatohen gjatë ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë së



gjuetisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Pezullimi i përdorimit të zonave të gjuetisë dhe pezullimi i gjuetisë në zonat e mbarështimit të faunës së egër

1. Përdorimi i zonave të gjuetisë, të dhëna për këtë qëllim nëpërmjet ofertës publike, sipas legjislacionit në fuqi për gjuetinë, pezullohet.

2. Kontratat për mbarështimin e faunës së egër janë të vlefshme, por edhe në këto zona, ku mbarështohet fauna e egër, nuk mund të ushtrohet gjuetia deri në afatin e zbatimit të këtij ligji.

Neni 4

Përrjashtim nga fusha e veprimit

1. Përrjashtohen nga fusha e zbatimit të nenit 2 të këtij ligji:

a) gjuetia në rastet e konstatimit të mbi-popullimit të një lloji të faunës së egër, në zonat e lejuara për gjueti dhe në rezervatet e mbarështimit, sipas legjislacionit në fuqi për gjuetinë;

b) gjuetia për qëllime kërkimore-shkencore.

2. Përrjashtimi, i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 5

Afati i zbatimit

Afati i zbatimit të këtij ligji është pesë vjet, nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 6

Sanksionet

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepr penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) kur shkelja kryhet e organizuar nga operatorët e tureve të gjuetisë, shoqatat e gjuetarëve ose federatat e gjuetarëve, subjekti që e organizon dënohet me gjobë në masën 800 000 (tetëqind mijë) - 1 000 000 (një milion) lekë;

b) kur shkelësi është një individ ose është individ, pjesëtar i subjekteve organizuese, sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, dënohet me gjobë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) - 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Në rastet e përsëritjes së shkeljes, nga subjektet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, përveç dënimit me gjobë, vendoset si dënim plotësues edhe heqja e lejes së gjuetisë, si dhe konfiskimi i armës së gjahut.

3. Shqyrtimi i kundërvajtjes bëhet nga inspektorati shtetëror përgjegjës për gjuetinë. Vendimi i dënimit, ankimi kundër tij dhe ekzekutimi i dënimeve me gjobë bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”, të ndryshuar.

Neni 7

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit

Ngarkohen ministri i Mjedisit, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Financave, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e këtij ligji.

Neni 8

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të këtij ligji.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miruar në datën 2.6.2016

Shpallur me dekretin nr. 9640, datë 14.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 62/2016

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9948, DATË 7.7.2008, “PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 17, fjalia e dytë, e shkronjës “e”, të pikës 1/1, ndryshohet si më poshtë:

“Afat i plotësisë të AMTP-ve përfundon në datën 31 dhjetor 2017.”.

Neni 2

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Verifikimi i titujve të pronësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, përfundon më 31 dhjetor 2017.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.6.2016

Shpallur me dekretin nr. 9641, datë 14.6.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**LIGJ
Nr. 63/2016**

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 171/2014, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-

ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 6, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve mbyllet në datën 31 dhjetor 2017.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.6.2016

Shpallur me dekretin nr. 9642, datë 14.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**LIGJ
Nr. 64/2016**

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS DHE PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, E OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA, SI AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “LINJA E TRANSMETIMIT 400 KILOVOLT SHQIPËRI-KOSOVË (TIRANË-PRISHTINË)”, NËPËRMJET NJË HUAJE PREJ 42 000 000 EUROSH

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga



Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si Agjencia e Zbatimit të Projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri–Kosovë (Tiranë–Prishtinë)”, nëpërmjet një huaje prej 42 000 000 (dyzet e dy milionë) eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.6.2016

Shpallur me dekretin nr. 9643, datë 14.6.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

KfW Bankengruppe, Postach 111141, 60046, Frankfurt am Main
Operatorit të Sistemit të Transmetimit
Engjëll Zeqo
Bulevardi “Bajram Curri”, rruga 5
Tiranë, Shqipëri

Ministria e Financave
Ministër Shkëlqim Cani

Për dijeni: Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Ministër Damian Gjijnuri

Datë: 2 shkurt 2016
KfW Development Bank
Peter Ley
Referenca jonë: PeLe
Phone: +49 69 7431-3412
Fax: + 49 69 7431-3490
Peter.Ley@kfw.de

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Shtyrja e Afatit të Disbursimit
Linja e transmetimit 400 kv Shqipëri–Kosovë (Tiranë–Prishtinë)

Marrëveshja e Huas dhe projektit

Datë: 04 janar 2010
Vlerë: 42 milionë euro
BMZ no.: 2008 65 196
Llogaria e huas nr.: 2531222

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes së lartpërmendur dhe letres së Ministrisë së Financës, të datës 3 dhjetor 2015, në të cilën kërkoni për një zgjatje të afatit të disbursimit.

Ne jemi të kënaqur që nëpërmjet kësaj t’ju informojmë ju, se ne pranojmë kërkesën tuaj dhe se kemi marrë miratimin e brendshëm që të mbartim vetë në këtë rast kostot shpenzimet e rifinancimit dhe jo t’ia ngarkojmë klientit.

Pas vonesave fillestare në zbatimin e projektit, me këtë pranojmë ndryshimet e mëposhtme të Marrëveshjes:

Seksioni A, “Ndryshimin e Marrëveshjes së Huas”;

Marrëveshja e Huas (BMZ-No. 2008 65 196) do të ndryshojë si më poshtë:

Neni 3.2 “Afati i fundit për të kërkuar disbursimin”, do të fshihet dhe do të zëvendësohet si vijon:

“KfW-JA mund të refuzojë disbursimet pas 30 dhjetorit 2017. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja mund të realizojë shtyrjen e afatit, duke informuar Huamarrësin sipas gjykimit të saj.”.

Seksioni B, “Dispozita të tjera”

1. Kjo letër nuk do të ndryshojë ose heq dorë nga ndonjë dispozitë tjetër e Marrëveshjes së Huas, përveç siç është përcaktuar shprehimisht në këtë letër.

2. Dispozitat e nenit 10 (“Kostot dhe detyrimet publike”), neni 11.5 (“Pajtueshmëria”), neni 13.2 (“Adresat”), neni 14.3 (“Pavlefshmëria e pjeshme dhe boshllëqet”), dhe neni 14.4 (“Forma e shkruar dhe amendimet”), neni 14.6 (“Ligji i zbatueshëm”) dhe 14.9 (“Mosmarrëveshjet ligjore – Arbitrazhi”) i Marrëveshjes do të përfshihen në këtë letër, sikurse është e përcaktuar në mënyrë të plotë në këtë letër dhe sikurse referencat në ato dispozita të Marrëveshjes i referohen kësaj letre.

Ju lutem, konfirmoni miratimin tuaj për ndryshimin dhe dispozitat shtesë të përmendura më lart, duke nënshkruar në një formë ligjërish të detyrueshme dhe kthimin e një prej kopjeve të ne sa më shpejt të jetë e mundur.

Me respekt,
KfW
Rainer Sunnen
Senior Project Manager
KfW Entwicklungsbank



Peter Ley
Project Manager
KfW Entwicklungsbank

Lexuar dhe pranuar:

Tiranë: _____ 2016

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë

Emri:

Titulli:

Ndreqje gabimi

Në nenin 63 të ligjit nr. 136/2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 220/2015, datë 22 dhjetor 2015, faqe 14466, bëhet ndreqja e gabimit si më poshtë:

“Neni 63

Në nenin 147, në pikën 1, hiqet togfjalëshi “**kryen shërbimin ushtarak**”, ndërsa në pikën 2 hiqet togfjalëshi “**të thirret në shërbimin ushtarak**”.

DEKRET

Nr. 9645, datë 14.6.2016

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Kulturës dhe ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Mehdi Faik Zhugolli
2. Isak Maksut Duraku
3. Latif Sabit Hasolli
4. Burim Mufail Haliti
5. Almir Agim Selimi
6. Shyqri Ramiz Nimani
7. Albert Ramiz Heta

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë